



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.2021

**VENDIM**  
**Nr. 203, datë 20.05.2021**

**PËR**  
**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT {...}, PËR VITIN 2019**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2019”, i hartuar nga relatore znj. Brikena Ukperaj,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
  - A. Aftësitë profesionale – “Shumë mirë”;
  - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
  - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
  - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shumë mirë”.  
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shumë mirë”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË ETIKËS DHE  
VEPRIMTARISË PROFESSIONALE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

RAPORT  
VLERËSIMI ETIK DHE PROFESIONAL I GJYQTARIT  
{...}  
VITI 2019

POLI I DREJTËSISË

RRUGA “ANA KOMNENA”

TIRANË

---

## ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PËRCAKTIMI I NIVELIT TË VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

---

### 1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsyetimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimore. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsyetimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.*

#### 1. A Njohuritë ligjore.

**1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.**

Përcaktimi i objektit të mosmarrëveshjes që i paraqitet gjykatës për zgjidhje është në disponibilitetin ekskluziv të palëve, por nga ana tjetër në mbështetje të nenit 16 të K.Pr.Civile është gjykata ajo që bën një cilësim të saktë të fakteve që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi dhe përrnjedhojë nuk është e lidhur me bazën apo referencën ligjore të palës paditëse. Gjithashtu në bazë të nenit 375 të K.Pr.Penale, pavarësisht akuzës së ngritur nga ana e organit të akuzës, me vendimin përfundimtar gjykata mund t'i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj.

Sa më sipër, roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, fakt ky i cili do të përcaktojë edhe natyrën juridike të saj, e për pasojë edhe referencën relevante për zbatim në zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

*Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :*

- **Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes:**

Gjyqtari përshkuan faktet dhe rr Ethanat e çështjes, duke i sjellë ato nëpërmjet analizës së provave të marra gjatë shqyrtimit në shkallë të parë, por edhe gjatë gjykimit në apel, në ato

raste kur gjykata e apelit ka përsëritur pjesërisht shqyrtimin gjyqësor<sup>1</sup>. Në disa prej çështjeve të analizuara gjyqtari ka dalë me mendim kundër (nga 8 çështje burim vlerësimi, 4 prej tyre përbajnjë mendimin kundër të gjyqtarit), duke argumentuar mendimin e tij në procesverbalin që i bashkëlidhet vendimit gjyqësor, dhe për pasojë, paraqitja e fakteve të çështjes në këto akte (mendimin kundër) paraqet një situatë specifike, pasi faktet dhe rrëthanat e çështjes paraqiten në mënyrë të kufizuar, kushtëzuar nga vetë natyra e aktit, si dhe sipas vlerësimit të gjyqtarit, në atë masë që i shërbijnë argumentimit të mendimit kundër.

Duke u nisur nga mënyra se si janë paraqitur rrëthanat e çështjes në 8 vendimet/mendimet e pakicës të analizuara, pavarësisht kategorisë së çështjes apo llojit të gjykimit të zhvilluar, faktet e çështjes, paraqiten në pjesën e parë të pjesës përshkruese - arsyetuese të vendimit, duke u shoqëruar në çdo rast me analizën e provave mbi të cilat mbështeten dhe prej të cilave rezultojnë faktet konkrete. Duke iu referuar specifikave të gjykimit në apel, gjyqtari është kujdesur të evidentojnë para parashtrimit të fakteve të çështjes, qëndrimin e gjykatës së apelit sa i përket arsyetimit të gjykatës së shkallës së parë në vendimin objekt ankimi, duke risjellë (nëpërmjet referimit dhe citimit) në rastet kur ky qëndrim është i njëjtë, pjesë të rrëthanave të faktit siç janë analizuar dhe pranuar në vendimin objekt ankimi<sup>2</sup>. Evidentohet se, në paraqitjen e fakteve të çështjes, si në raport me faktin penal objekt gjyki, dyshimin e arsyeshëm apo faktet e çështjes civile, gjyqtari i kushton rëndësi paraqitjes së tyre nëpërmjet referimit të drejtpërdrejtë dhe analizës së provave e akteve të administruara në gjykim, prej të cilave rezulton fakti apo rrëthana procedurale konkrete. Në disa nga çështjet e analizuara, faktet e çështjes nuk janë paraqitur dhe përshkruar të plota, por duke u bërë pjesë e arsyetimit të vendimit vetëm faktet që lidhen me vlerësimin e gjykatës për parashkrimin e padisë<sup>3</sup>, ose faktet e çështjes që lidhen me qëndrimin kundër të gjyqtarit sa i përket formës së bashkëpunimit<sup>4</sup>, kompetencës lëndore të gjykatës<sup>5</sup>, përbërjen e trupit gjykues<sup>6</sup>, etj. Kjo pasi rrëthanat e faktit për pjesën tjetër, sa i përket faktit penal të provuar në gjykim, janë pjesë e analizës së fakteve të çështjes në vendimin gjyqësor dhe prej gjyqtarit nuk është vlerësuar e nevojshme të përshkruhen në mendimin kundër.

Edhe pse në dokumentet ligjore (vendime dhe mendime kundër) nuk rezulton një nën pjesë e titulluar “Rrëthanat e faktit”, referuar mënyrës së përshkrimit të tyre, duke i integruar me provat e administruara, faktet përgjithësisht evidentohen qartë dhe zënë një peshë specifike të përbajtjes së pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimeve gjyqësore të analizuara. Në mendimet kundër, faktet e çështjes apo rrëthanat procedurale, janë paraqitur në mënyrë tepër të kufizuar. Në një rast në të cilin faktet e çështjes janë voluminoze dhe me disa episode, gjyqtari i ka evidentuar dhe parashtruar rrëthanat e faktit duke i ndarë më vetë për secilin episod dhe person të dyshuar, duke i dhënë qartësi dhe kuptueshmëri paraqitjes së tyre dhe evidentimit të veprimeve konkrete të secilit person për të cilin është caktuar masa e sigurimit objekt ankimi<sup>7</sup>. Në 2 mendime pakice ku gjyqtari për procedurë (mosformim i rregullt i gjykatës të caktuar me ligj dhe mungesa e kompetencës lëndore) ka mbajtur qëndrim të

<sup>1</sup> Vendimi nr. 56, datë 26.07.2019 i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe mendim kundër bashkëlidhur vendimit.

<sup>2</sup> Vendimi nr. 56, datë 26.07.2019.

<sup>3</sup> Vendimi nr. 232, datë 08.04.2019 i Gjykatës së Apelit Vlorë.

<sup>4</sup> Mendim pakice bashkëlindur vendimit nr. 32, datë 02.05.2019 dhe mendim pakice bashkëlidhur vendimit nr.12, datë 07.02.2019 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda.

<sup>5</sup> Mendim pakicë bashkëlidhur vendimit nr. 22, datë 13.03.2019 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda.

<sup>6</sup> Mendim pakicë bashkëlidhur vendimit nr. 56, datë 26.07.2019 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda.

<sup>7</sup> Vendim nr. 32, datë 28.05.2019 i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda.

ndryshëm nga shumica, rrethanat e faktit nuk pasqyrohen, ndërsa ecuria procedurale e çështjes paraqitet në mënyrë tepër të kufizuar<sup>8</sup>.

- ***Identifikimi i natyrës së çështjes:***

Nga identifikimi dhe përshkrimi i fakteve dhe rrethanave procedurale të çështjes, gjyqtari konkludon për natyrën e çështjes objekt shqyrtimi. Edhe pse ky element nuk është identifikuar në mënyrë të shprehur në vendime, rezulton i qartë duke iu referuar objektit të ankimit dhe kompetencës lëndore të Gjykatës së Apelit për Krimet të Rënda. Në mendimet e pakicës të hartuara nga gjyqtari, natyra e çështjes rezulton nga objekti i saj dhe përbajtja e vendimit të marrë nga trupa gjyqësore, ndërkohë që në këto akte gjyqtari përqendrohet vetëm në pasqyrimin e argumenteve lidhur me qëndrimin e tij kundër vendimmarrjes përfundimtare të trupit gjykues për çështjen. Në një çështje të kategorisë civile, gjyqtari pas evidentimit vetëm të rrethanave të faktit që kanë të bëjnë me shkakun e ankimit sa i përket parashkrimit të padisë, i ka kushtuar rëndësi përcaktimit të natyrës së çështjes dhe institutit përkatës juridik (*shpërblim dëmi jashtëkontraktor*) me qëllim vlerësimin e pretendimit të palës ankuese sa i përket parashkrimit të padisë<sup>9</sup>.

- ***Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm:***

Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës për shqyrtimin e çështjes, por gjithashtu lidhet me identifikimin e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në këtë aspekt, referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtari identifikon dhe referon ligjin e zbatueshëm, duke treguar kujdes në citimin të kufizuar të dispozitave ligjore, vetëm kur ato referojnë në zgjidhjen e çështjes dhe i nënsstrohen me tej interpretimit të tyre. Duke i ndarë vendimet gjyqësore/mendimet kundër objekt vlerësimi në dy kategori (i) civile dhe (ii) penale, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material dhe atij procedural të evidentuar për zgjidhjen e pretendimeve objekt ankimi, konstatohet se:

(i) Në vendimin civil (mosmarrëveshje në lidhje me shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor), gjyqtari identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes duke iu referuar dispozitave materiale të Kodit Civil, në lidhje me afatin e parashkrimit të padisë, fillimin e afatit të parashkrimit dhe momentin e lindjes së të drejtës së padisë (*referohen nenet 117, 120 dhe 115 të Kodit Civil*).

(ii) Në vendimet penale/mendimet kundër, gjyqtari identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në pjesën e përgjithshme dhe të posaçme të Kodit Penal, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit si dhe dispozitat procedurale për të vlerësuar elementë të ecurisë procedurale të gjykimit, apo kushtet dhe kriteret e caktimit dhe zbatimit të masave të sigurimit personal në çështjet që kanë të bëjnë me kërkesat penale të fazës së hetimeve paraprake. Konkretnisht në vendimet të cilat kanë për objekt shqyrtimit e kërkesave të fazës së hetimit paraprak<sup>10</sup>, gjyqtari identifikon nenet 229, 229 dhe 260 të K.Pr.P për të vlerësuar kushtet dhe kriteret e

<sup>8</sup> Mendimet e pakicës bashkëngjitur vendimeve Nr.22 dt. 13.03.2019 dhe Nr. 56 dt. 26.07.2019 të Gjykatës së Apelit për Krimet të Rënda.

<sup>9</sup> Vendimi nr.232, datë 08.04.2019 i Gjykatës së Apelit Vlorë.

<sup>10</sup> Vendimet nr. 32, datë 28.05.2019, nr. 148, datë 11.07.2019 dhe nr. 41, datë 16.07.2019 të Gjykatës së Apelit për Krimet të Rënda.

caktimit dhe zbatimit të masave të sigurimit personal, përshtatshmérinë e masës së caktuar në raport me faktin penal për të cilin procedohet si dhe kushtet ligjore që duhet të ekzistojnë për zëvendësimin e masës së sigurimit, në një rast<sup>11</sup>. Në këto vendime, veç ligjit procedural, gjyqtari identifikon si ligj të zbatueshëm edhe nenet respektive të Kodit Penal, për efekt të përcaktimit të kualifikimit ligjor të faktit penal për të cilin dyshohet personi nën hetim dhe rëndësisë së tij në raport me vlerësimin e përshtatshmërisë së masës së sigurimit. Në këtë kontekst identifikohet si dispozita materiale të zbatueshme neni 28, pg. 4 dhe 5, i Kodit Penal, lidhur me ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm për kryerjen e veprës penale nëpërmjet formës së veçantë të bashkëpunimit, neni 22 i Kodit Penal sa i përket mbetjes së veprës penale për të cilën procedohet në fazën e tentativës<sup>12</sup>, si dhe nenet 283/a, 333/a, 334 dhe 287 të Kodit Penal për efekt të cilësimit ligjor të faktit penal për të cilin procedohen personat ndaj të cilëve është caktuar masa e sigurimit objekt ankimimi.

Në mendimet kundër, gjyqtari identifikon si ligj të zbatueshëm, në mbështetje të qëndrimit të tij, dispozita të ligjit material me qëllim cilësimin e faktit, apo elementëve të caktuar të tij. Konkretnisht gjyqtari referon në nenin 28 të Kodit Penal, në lidhje me formën e bashkëpunimit, në mbështetje të qëndrimit të tij se forma e bashkëpunimit është ajo e posaçme (grup i strukturuar kriminal) dhe jo bashkëpunim i thjeshtë<sup>13</sup>.

*Sa i përket ligjit procedural të zbatueshëm, identifikohet referimi ose citimi i dispozitave procedurale penale (neni 425 të K.Pr.Penale) në lidhje me kufijtë e shqyrimit të çështjes në Apel, duke u cilësuar si parakusht procedural në fillimin të analizës së shkaqeve të ankimit, apo si kufizim ligjor që shoqëron argumentimin në rast të mos rëndimit të pozitës së të pandehurit, kur anki i vjen prej tij në lidhje me cilësimin ligjor të faktit penal<sup>14</sup>. Gjyqtari referon nenin 428<sup>15</sup> të K.Pr.Penale lidhur me qëndrimin e tij për disponimin përfundimtar të gjykatës, në rastet kur ka vlerësuar ndryshe nga shumica. Gjyqtari identifikon si ligj të zbatueshëm dispozitat në lidhje me përbërjen e trupit gjykues, sipas dispozitave tranzitore të ligjit nr. 35/2017 (nenin 13 të K.Pr.P dhe nenin 285/7 të ligjit nr. 35/2017), kompetencën lëndore të gjykatës<sup>16</sup> (nenin 75/a të K.Pr.P), në mbështetje të qëndrimit të tij lidhur me këto aspekte procedurale apo në përgjigje të kërkesave të palëve lidhur me kompetencën lëndore të gjykatës për shqyrimin e çështjes. Gjyqtari identifikohen si ligj i zbatueshëm nenet 128/a, 332/dh, në mbështetje të qëndrimit lidhur me kualifikimin ligjor të faktit penal, pasojat e kualifikimit të gabuar në raport me vlefshmérinë e vendimit, si dhe rolin e gjyqtarit të seancës paraprake apo gjykatës së themelit në shkallë të parë në drejtim të cilësimit juridik të faktit penal<sup>17</sup>.*

Në një rast, në mendimin kundër të hartuar nga gjyqtari, parashtronen shkurtimisht vetëm elementë të ecurisë procedurale të çështjes sa i përket çështjes së kompetencës lëndore, pa u identifikuar ligji i zbatueshëm në mbështetje të konkluzionit të gjyqtarit për mungesë të kompetencës lëndore të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda apo për të mbështetur

<sup>11</sup> Vendimi nr. 148, datë 11.07.2019 i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda.

<sup>12</sup> Vendimi nr. 32, datë 28.05.2019 i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda.

<sup>13</sup> Mendim kundër bashkëlidhur vendimit nr. 32, datë 02.05.2019 dhe mendim kundër bashkëlidhur vendimit nr. 12, datë 07.09.2019 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda.

<sup>14</sup> Mendim pakice, vendimi nr. 32, datë 02.05.2019.

<sup>15</sup> Mendim pakice, vendimi nr. 12, datë 07.02.2019, mendim pakice, vendimi nr. 56, datë 26.07.2019, mendim pakice vendimi nr. 32, datë 02.05.2019.

<sup>16</sup> Vendimi nr. 148, datë 11.07.2019.

<sup>17</sup> Mendim pakice, vendimi nr. 32, datë 02.05.2019, mendim pakice, vendimi nr. 56, datë 26.07.2019, mendim pakice, vendimi nr. 12, datë 07.03.2019.

qëndrimin e tij për moszbatimin e vendimit të Gjykatës së Lartë që ka zgjidhur konfliktin e kompetencës mes gjykatës së juridiksonit të përgjithshëm dhe atij të posaçëm<sup>18</sup>.

**-Konflikti i normave materiale apo procedurale:**

Në vendimet gjyqësore dhe mendimet e pakicës burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtari ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në rastin konkret.

**KONKLUZIONE:**

Në tërsi, referuar të dhënavë që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi në identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes dhe identifikimit të normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim, por shkalla e aftësisë ndryshon nga vendimet penale në ato civile. Në të vetmin vendim civil burim vlerësimi, përshkrimi i kufizuar i faktit, nuk arrin të krijojë për lexuesin një pamje të qartë dhe të plotë të çështjes. Kjo e fundit evidentohet edhe në rastet e mendimeve kundër, ku mungesa e paraqitjes në mënyrë të plotë të ecurisë procedurale të çështjes, nuk realizon lidhje të pandërprerë midis asaj çka ka ngjarë dhe vlerësimit të gjyqtarit. Sa i përket identifikimit të ligjit të zbatueshëm, gjyqtari në shumicën e dokumenteve burim vlerësimi identifikon dhe referon ligjin procedural dhe/ose material të zbatueshëm, në shërbim të analizës dhe vlerësimit të tij, përveç një rasti, kur në mendimin kundër gjyqtari nuk ka identifikuar dhe as ka referuar dispozita të ligjit në mbështetje të qëndrimit të tij lidhur me kompetencën lëndore të gjykatës dhe moszbatimin e vendimit të Gjykatës së Lartë që ka zgjidhur konfliktin e kompetencës.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:*** Pas analizës së të dhënavë që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Mbi mesatare”, duke u pikëzuar me 20 pikë.

**1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.**

Interpretimi i ligjit është ekskluzivitet i gjyqtarit, interpretim i cili duhet të bëhet duke dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt normës ligjore. Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet ti japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përbajtjes dhe qëllimit të tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :***

Në katër vendimet burim vlerësimi dhe tre nga katër mendimet kundër të hartuara nga gjyqtari, identifikimi i normës procedurale ose materiale, si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve të çështjes, duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtari lidhur me zbatimin e saj. Në aktet e analizuara, kryesisht normat ligjore referohen dhe aplikohen mbi faktet e çështjes, duke u shoqëruar vetëm në disa raste me interpretimin e tyre.

<sup>18</sup>Mendim kundër, vendimi nr. 22, datë 13.03.2019 I Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda.

Në katër vendimet gjyqësore burim vlerësimi, dispozitat e ligjit procedural dhe material penal, si dhe ligjit material civil në një rast, referohen, citohen pjesërisht duke u aplikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë mbi faktet dhe rrëthanat e çështjes, pa interpretim të pavarur të tyre.

Në dy mendime kundër, para aplikimit mbi faktet e çështjes, dispozitat e ligjit material penal, referohen dhe interpretohen në nivel teorik, kryesisht në lidhje me formën e bashkëpunimit, në funksion të dhënisë së kuptimit të dispozitës, përcaktimit dhe klasifikimit të kërkuesave të ligjit për ekzistencën e formës së veçantë të bashkëpunimit<sup>19</sup>. Në këto raste gjyqtari kryesisht përdor interpretimin ligjor të normës konkrete (*nenit 28 të Kodit Penal*) dhe, duke e përqasur atë me faktet e nxjerra nga analiza e provave të shqyrtuara, arrin në konkluzionin në lidhje me qëndrimin e tij sa i përket formës së bashkëpunimit. Në një rast të mendimit të pakicës, lidhur me kompetencën lëndore të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, nuk rezulton të ketë referim dhe as interpretim të ndonjë norme procedurale, në mbështetje të qëndrimit të gjyqtarit për mungesën e kompetencës lëndore të gjykatës si dhe për qëndrimin e ndryshëm nga vendimi i Gjykatës së Lartë që ka zgjidhur konfliktin e kompetencës duke e dërguar çështjen për vazhdimin e gjykimit pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda<sup>20</sup>.

- ***Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm:***

Interpretimi i normave juridike të ligjit material penal ose civil, *në disa* nga dokumentet e analizuara, është bërë duke identifikuar qëllimin e normës, përcaktimit të kushteve dhe kritereve që duhet te plotësohen në mënyrë kumulative ose alternative, që të gjejë zbatim dispozita konkrete. Konkretisht, në disa prej vendimeve gjyqësore/mendimet kundër burim vlerësimi, sa i përket interpretimit të ligjit material, rezulton se:

- (i) Në lidhje me formën e veçantë të bashkëpunimit, në formën e grupit të strukturuar kriminal, gjyqtari interpreton nenin 28, pg 4 dhe 5 të Kodit Penal duke dhënë kuptimin e tij, duke përcaktuuar dhe grupuar kushtet e përcaktuara nga ky nen për ekzistencën e formës së veçantë të bashkëpunimit, natyrën kumulative të kushteve të përgjithshme dhe natyrën fakultative të kushteve të grupit të dytë, duke konkluduar për ekzistencën e formave të veçanta të bashkëpunimit në raport me bashkëpunimin e thjeshtë si rrëthanë cilësuese apo rënduese. Ky interpretim, shoqëruar më pas me aplikimin mbi faktet e çështjes konkrete, është bërë në funksion të kualifikimit të faktit penal me qëllim vlerësimin për rezikshmërinë e veprës penale për të cilën procedohet në rastet e vlerësimit të përshtatshmërisë së masës së sigurimit<sup>21</sup> si dhe në rastet e qëndrimit kundër të gjyqtarit në raport me cilësimin ligjor të faktit penal objektakuze, në çështjet e themelit<sup>22</sup>.

Përveç këtyre rasteve, në aktet e tjera burim vlerësimi, nuk rezulton interpretim i dispozitave të ligjit material që gjejnë zbatim mbi faktet e çështjes, për shkak se gjyqtari ka ndjekur metodologjinë e aplikimit të drejtpërdrejtë të normës mbi faktet e provuara.

- ***Përsa i përket interpretimit të dispozitave procedurale:***

<sup>19</sup>Mendim kundër bashkëlidhur vendimit nr. 32, datë 02.05.2019 dhe mendim kundër, bashkëlidhur vendimit nr. 12, datë 07.02.2019.

<sup>20</sup>Mendim kundër bashkëlidhur vendimit nr. 22, datë 13.03.2019.

<sup>21</sup>Vendimi nr. 41, datë 16.07.2019 , vendimi nr. 32, datë 28.05.2019, vendimi nr.128, datë 11.07.2019.

<sup>22</sup>Mendim kundër, bashkëlidhur vendimit nr. 12, datë 07.02.2019, mendim kundër, bashkëlidhur vendimit nr. 32, datë 02.05.2019.

Gjyqtari në varësi të natyrës së çështjes si dhe qëndrimit të tij për aspekte procedurale të çështjes, *në disa* raste ka interpretuar, në përputhje me rrethanat e faktit apo ato procedurale, dispozita të caktuara të Kodit të Procedurës Penale, duke dhënë kuptimin e tyre referuar qëllimit të dispozitës, dhe më pas duke e aplikuar mbi faktin/rrethanën konkrete mbi të cilin ajo gjen zbatim. Konkretisht, në disa prej vendimeve gjyqësore/mendimet kundër burim vlerësimi, sa i përket interpretimit të ligjit procedural, rezulton se:

- (i) Për të konkluduar për rastet e pavlefshmërisë absolute të akteve dhe pasojat e saj, në rastet kur nuk janë respektuar dispozitat për thirrjen e të pandehurit dhe të drejtën e prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale për shkak të kualifikimit ligjor jo të saktë, gjyqtari interpreton nenet 128/a, pika 1 dhe 425, paragrafi 3 të K.Pr.P, për të mbështetur qëndrimin lidhur me pasojat e kualifikimit jo të duhur ligjor të faktit penal, nga gjyqtari i seancës paraprake si dhe gjykata e themelit që ka gjykuar çështjen në shkallë të parë<sup>23</sup>.
- (ii) Për të përcaktuar kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për caktimin dhe zbatimin e masave të sigurimit personal, vlerësimin e përshtatshmërisë së masës në raport me faktin për të cilin procedohet, gjyqtari interpreton nenin 228 dhe 229 të K.Pr.P, duke përcaktuar edhe natyrën kumulative të kushteve të përgjithshme dhe atë alternative të kushteve të posaçme për caktimin e masave të sigurimit<sup>24</sup>.
- (iii) Për të mbështetur qëndrimin e tij sa i përket përbërjes së trupit gjykues të shkallës së parë, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 35/2017, deri në momentin e krijimit të Gjykatës së Posacme për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar, interpreton nenin 285, paragrafi 7 të ligjit nr. 35/2017.

Veç rasteve si më sipër, në dokumentet e tjera burim vlerësimi, nuk rezulton të jenë interpretuar dispozita të ligjit procedural, pasi referimi i tyre është ndjekur nga aplikimi i drejtpërdrejtë mbi faktet e çështjes, pa u shoqëruar me interpretimin paraprak dhe dhënien e kuptimit të normës juridike të zbatueshme mbi rastin konkret.

- **Në lidhje me aftësinë e gjyqtarit për të përdorur jurisprudencën relevante.**

Në të gjitha vendimet dhe mendimet kundër të analizuara, nuk rezulton në asnjë rast që gjyqtari të ketë identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante në mbështetje të argumenteve në lidhje me interpretimin e ligjit dhe zbatimin e tij.

- **Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës**

Gjatë aplikimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, gjyqtari zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës, duke i përmendor ato shprehimisht apo duke iu referuar kontekstit të arsyetimit, në rastet si më poshtë:

- (i) Në qëndrimet e tij lidhur me kualifikimin ligjor të faktit penal dhe pasojat e kualifikimit jo të duhur të tij gjatë gjykimit në shkallë të parë, kur çështja është apeluar vetëm prej të pandehurit, gjyqtari përmend parimin procedural të mos rendimit të pozitës së të pandehurit duke referuar nenin 425 paragrafi 3 të K.Pr.P, në shërbim të konkluzionit të tij për prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim<sup>25</sup>.

<sup>23</sup>Mendim kundër, bashkëlidhur vendimit nr. 32, datë 02.05.2019, mendim kundër bashkëlidhur vendimit nr. 12, datë 07.02.2019.

<sup>24</sup>Vendimi nr. 148, datë 11.07.2019, vendimi nr. 32, datë 28.05.2019 dhe vendimi nr. 41, datë 16.07.2019.

<sup>25</sup>Mendim kundër, bashkëlidhur vendimit nr. 32, datë 02.05.2019, mendim kundër bashkëlidhur vendimit nr. 12, datë 07.02.2019.

(ii) Në mbështetje të qëndrimit lidhur me pamundësinë e ndryshimit të kualifikimit ligjor të faktit penal në drejtim të rëndimit të pozitës së të pandehurit, gjatë gjykimit në apel, kur çështja është ankumuar vetëm prej tij, gjyqtari përmend dhe analizon parimin e kontradiktoritetit dhe rëndësinë e tij në kontekstin e cilësimit të duhur juridik të faktit penal objektakuze<sup>26</sup>.

## KONKLUZIONE:

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen, por ky interpretim është tepër i kufizuar, duke u evidentuar vetëm në disa nga dokumentet ligjore të analizuara, ndërkohë që në pjesën tjeter, ligji procedural dhe material referohet dhe zbatohet drejtpërdrejt mbi faktet e çështjes, pa u shoqëruar me dhëni e kuptimit të dispozitës si dhe mënyrën e zbatimit të tij mbi faktin konkret. Nuk rezulton në asnjë rast që interpretimi i ligjit procedural ose material të jetë shoqëruar me identifikimin dhe referimin e jurisprudencës relevante, çka do të përbente vlerë të shtuar në mbështetje të qëndrimit për mënyrën e zbatimit apo interpretimit të normave juridike.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:*** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Mesatare”, duke u pikëzuar me 15 pikë. Ky konkluzion bazohet në analizën e metodologjisë së përgjithshme të punës së gjyqtarit në drejtim të këtij treguesi, duke analizuar të gjitha llojet e çështjeve të përzgjedhura, pa i dhënë peshë dhe rëndësi të vecantë asnjërisë prej tyre. Vlerësimi i gjyqtarit për këtë tregues nuk cenon ekskluzivitetin e gjyqtarit për të interpretuar ligjin, ndryshe nga sa parashtron në kundërshtimet e tij gjyqtari.

### 1.B Arsyetimi ligjor

#### 1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

**Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :**

Vendimet gjyqësore janë të qarta dhe të kuptueshme për një lexues të arsyeshëm, jo vetëm për njohësit e ligjit. Gjyqtari ka përdorur përgjithësisht fjali me gjatësi mesatare, dhe në disa raste fjali të gjata, të cilat ndahen në pjesë përmes përdorimit të simboleve, por pa cenuar kuptimin e fjalisë në tëresinë e saj.

Nuk evidentohet përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, apo përdorimi i fjalëve fyese ose denigruese. Gjyqtari përdor përgjithësisht të gjitha shkronjat e alfabetit shqip si dhe përdor në disa raste simbole përfshirë fjalë apo lidhëza të gjuhës shqipe, me qëllim ndarjen e pjesëve të nënrenditura të fjalisë. Kjo mënyrë e të shkruarit vështirëson leximin, por nuk dëmton kuptueshmërinë e vendimit në tëresi.

<sup>26</sup> Mendim kundër bashkëlidhur vendimit nr. 32, datë 02.05.2019 dhe mendim kundër bashkëlidhur vendimit nr.12, datë 07.02.2019.

Karakteristike e gjyqtarit në mënyrën e ndërtimit të fjalive është edhe integrimi në përbajtje të tyre i pjesëve nga përbajtja e provave apo referimi i dispozitave ligjore procedurale ose materiale (nenet vendosen në përbajtje të fjalisë mes kllapave). Vendimet janë të organizuar në paragrafë të cilët janë në vijimësi të njëri-tjetrit dhe në disa raste konstatohet fillimi i fjalisë hyrëse të paragrafit me shkronjë të vogël. Në çështjet në të cilat fakti është kompleks dhe me disa episode të ndara, gjyqtari i ka paraqitur dhe analizuar faktet dhe shkaqet e ankimit të secilit subjekt në mënyrë të ndarë, duke numërtuar pjesët përkatëse ku analizohet secili fakt, duke i dhënë qartësi dhe kuptueshmëri vendimit në këtë drejtim<sup>27</sup>.

Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi në lidhje me kuptimin e tyre, apo të kontekstit të cilin përdoren. Në mendimet e pakicës, arsyetimi është i organizuar në një ose disa paragrafë, duke ndjekur të njëjtën strukturë të ndërtimit të tij sikurse arsyetimi i vendimeve : *i)* me parashtrimin e qëndrimit të gjyqtarit sa i përket vendimmarrjes së shumicës, *ii)* parashtrimin e faktit konkret apo rrëthanës konkrete procedurale që përbën thelbin e qëndrimit të tij kundër, *iii)* dhënien e argumenteve lidhur me qëndrimin e tij si dhe *iv)* konkluzionin lidhur me mënyrën e disponimit të gjykatës, sipas vlerësimit të gjyqtarit dhe në përputhje me qëndrimin e tij.

## **KONKLUZIONE:**

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtari ka aftësi “shume të lartë” në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit/mendimit të pakicës së hartuar prej tij. Mosrespektimi në disa raste i rregullave drejtshkrimore, nuk është në atë masë sa të ndikojë në shkallën e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:*** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 15 pikë.

### ***1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit.***

Organizimi i arsyetimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj, do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumenteve ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kryesore të vendimit mund të humbasin apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsyetimi të ndjekë një format të qartë organizimi në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përbajtjes së vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje me mënyrën e strukturimit të një vendimi gjyqësor, e për pasojë i jep një liri gjyqtarit në strukturimin e tij, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsyetimit ligjor, shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike që juristët/gjyqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër, dhe pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC (*Issue, Rule, Application, Conclusion*), CRAC (*Conclusion, Rule, Application, Conclusion*) etj, të gjitha këto metoda duhet të janë në funksion të argumentimit ligjor të përdorur nga gjyqtari në zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen/ pyetjen për zgjidhje, normën relevante që do të duhet të zbatohet për

<sup>27</sup> Vendimi nr. 32, datë 28.05.2019 i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda.

zgjidhjen saj, analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje dhe konkluzioni i arritur.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :***

Në vendimet burim vlerësimi, gjyqtari ka ndjekur një strukturë të njëjtë dhe të qëndrueshme të cilës i përbahet në prezantimit të fakteve të çështjes, identifikimit të ligjit të zbatueshëm (kur ai evidentohet) duke e bërë atë pjesë të analizës së faktit, si dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Gjithashtu konstatohet se gjyqtari në rastin konkret ka një metodologji të qartë dhe të njëjtë strukturimi, sipas pjesëve përbërëse të vendimit, duke evidentuar pjesën hyrëse, pjesën përshkruese arsyetuese dhe dispozitivin e vendimit.

*Në pjesën hyrëse* gjejnë pasqyrim të dhënat e identifikimit të çështjes, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët, objekti i shqyrtimit/ankimit, disponimi i gjykatës së shkallës së parë, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve në proces.

*Pjesa përshkuese – arsyetuese*, pavarësisht se nuk është e ndarë në aspektin vizual në nënndarje, referuar përbajtjes së saj, rezulton të ketë ndarje strukturore në mënyrën e paraqitjes së arsyetimit të vendimit. Konkretisht, arsyetimi fillon me qëndrimin e gjykatës së apelit mbi bazueshmërinë ose jo të ankimit, duke paraqitur në formën e një konkluzioni qëndrimin e gjykatës së apelit, për të vijuar më pas me paraqitjen e fakteve të çështjes, fakte të cilat përshkruhen dhe analizohen nëpërmjet analizës së provave të administruara. Pas analizës së provave, duke paraqitur nëpërmjet tyre edhe faktet e çështjes, arsyetimi i vendimit vijon me analizën e dispozitave ligjore, kryesisht atyre procedurale lidhur me dyshimin e arsyeshëm, kushtet dhe kriteret e caktimit dhe zbatimit te masave të sigurimit. Pas këtij arsyetimi, duke ndërthurur në të edhe faktet që kanë rezultuar të provuara gjatë gjykimit lidhur me kushtet dhe kriteret e caktimit të masave të sigurimit (të tre vendimet penale të analizuara lidhen me kërkesa të fazës së hetimit paraprak sa i përket masave të sigurimit), arsyetimi përmbyll me konkluzionin e arritur nga gjykata sa i përket bazueshmërisë ose jo të ankimit objekt shqyrtimi. Në vendimin civil burim vlerësimi, pjesa arsyetuese e vendimit përmban në fillim të saj konkluzionin e gjykatës lidhur me shkakun e ankimit sa i përket parashkrimit të padisë, duke vijuar më pas me paraqitjen e pjesshme të rr Ethanave të faktit, vetëm sa i përket elementëve që i shërbijnë konkluzionit lidhur me fillimin dhe përfundimin e afatit të parashkrimit të padisë. Pas paraqitjes së këtyre fakteve në një paragraf, arsyetimi vijon me vlerësimin lidhur me bazueshmërinë e këtij shkaku ankimi të marrë në analizë, duke u përmbyllur më konkluzionin përrëzimin e padisë.

Në asnjë prej vendimeve të analizuara nuk rezulton të janë evidentuar në pjesën hyrëse apo në një pjesë të arsyetimit të vendimit, dhe nuk kuptohet nëse ato janë marrë në analizë në pjesën përkatëse të arsyetimit. Në vendimin civil burim vlerësimi, përvëç faktit se shkaqet e ankimit nuk parashtronë të plota, mungon edhe evidentimi i qëndrimit të palës paditëse në apelit kundërshtues<sup>28</sup>.

*Në pjesën e dispozitivit* gjen pasqyrim disponimi i gjykatës konform nenit 466 të K.Pr.Civile apo nenit 428 të K.Pr.Penale, si dhe data e shpalljes së vendimit.

---

<sup>28</sup> Vendimi nr. 232, datë 08.04.2019 i Gjykatës së Apelit Vlorë.

Vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural, vendimet civile elementët e parashikuar në nenin 310 të K.Pr.Civile dhe nenit 466 te K.Pr.Civile dhe vendimet penale elementët e parashikuar në nenin 383 të K.Pr.Penale. Po kështu vendimet janë të strukturuara në paragrafë në rrjedhë logjike me njeri tjetrin.

Në mendimet e pakicës, gjyqtari ka ndjekur një tjetër strukturë në organizimin e arsyetimit, duke iu përshtatur natyrës së aktit. Arsyetimi fillon me paraqitjen e qëndrimit kundër të gjyqtarit lidhur me vendimmarrjen e shumicës dhe më pas me shtjellimin e fakteve të çështjes apo rrethanës procedurale të marrë në analizë prej tij, vetëm për shkakun për të cilin ai ka qenë kundër.

## KONKLUZIONE:

Në tërësi, referuar të dhënavë që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se metodologja e përdorur nga gjyqtari në strukturimin e vendimit gjyqësor, edhe pse në dukje shfaqet si një formë standarde dhe e qëndrueshme e përdorur prej tij, jo gjithmonë orienton lexuesin drejt analizës ezauruese dhe kuptueshmërisë së trajtimit gjithëpërfshirës së shkaqeve të ankimit.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi.***

Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit” vlerësohet “mbi mesataren” duke u pikëzuar me 8 pikë.

### ***1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.***

Vendimet duhet të arsyetoohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballet gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitiv të vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GjEDNj-ja është shprehur se, megjithëse gjykatave u lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, përsa u përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për t'u ankuar<sup>29</sup>.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :***

Në vendimet gjyqësore penale të analizuara rezulton se gjyqtari i ka kushtuar rëndësi specifike analizës së fakteve dhe rrethanave të çështjes, analizë e cila në çdo rast bëhet së bashku me analizën e provave të administruara. Përgjithësisht analiza e fakteve, në vendimet gjyqësore të analizuara, është e plotë dhe e qartë. Kjo cilësi analize spikat edhe

<sup>29</sup> Vendimi i GjEDNJ, çështja Hadjanastassiouvs Greqisë, dt. 16.12.1992, fq. 33.

në rastet kur analizohen se si kushtet dhe kriteret e caktimit, zbatimit dhe zëvendësimit të masave të sigurimit, zbatohen mbi fakte konkrete.

Por edhe pse analiza e detajuar e provave është pjesë e rëndësishme e arsyetimit të vendimit gjyqësor në tërësi, ajo nuk është e mjaftueshme për të gjykuar mbi cilësinë e analizës dhe argumentimit logjik të gjyqtarit. Nëse ajo nuk shoqérohet me të njëjtën shkallë kujdesi me analizën se si konceptet ligjore dhe institutet lidhen midis tyre apo se si ato zbatohen në një situatë të caktuar (faktet e provuara), argumentimi logjik nuk është shterues. Konkretisht në vendimin civil të analizuar, nuk evidentohet e njëjtë shkalle aftësie e gjyqtarit në identifikimin e marrëdhënieς shkak-pasojë si dhe analizës dhe argumentimit logjik, se si elementët e institutit të parashkrimit shues të padisë, zbatohen mbi faktet e çështjes në raport me shkaqet e ankimit. Në këtë rast arsyetimi nuk është gjithëpërfshirës, sepse gjyqtari i ka kushtuar vëmendje vetëm pretendimit që e ka konsideruar si të bazuar në ligj, pa shpjeguar mungesën e relevancës së duhur në ligj apo faktet e provuara, të pretendimeve të kundërta.

Në disa prej mendimeve kundër, arsyetimi lidhur me shkakun për të cilin gjyqtari ka mbajtur qëndrimin kundër, pas paraqitjes dhe analizës së fakteve ose rr Ethanave procedurale, bazohet në një zhvillim logjik të koncepteve ligjore. Në disa raste të tjera, argumentit të përdorur i mungon lidhshmëria e rr Ethanave procedurale të ecurisë së gjykimit të çështjes me normën ligjore, edhe kur ajo evidentohet. Në një nga këto raste, gjyqtari parashtron mendimin kundër vetëm nëpërmjet një parografi në të cilin parashtron qëndrimin e tij lidhur me kompetencën lëndore, pa u ndalur në argumentet përkatëse lidhur me këtë qëndrim<sup>30</sup>.

## KONKLUZIONE:

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se konciliteti i treguar nga gjyqtari për të përbledhur mendimin juridik, jo gjithmonë përfshin analizën se si konceptet, institutet apo dispozitat lidhen mes tyre, apo se si ato zbatohen në rr Ethanana të caktuara. Analiza jo gjithmonë është gjithëpërfshirëse referuar pretendimeve të palëve. Për këtë shkak, në metodologjinë e përgjithshme të ndërtimit të mënyrës së arsyetimit të gjyqtarit, evidentohet një cilësi "mbi mesataren" e analizës së zhvillimit logjik të koncepteve ligjore.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:*** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet "Mbi mesatare", duke u pikëzuar me 20 pikë. Ky konkluzion bazohet në analizën e metodologjisë së përgjithshme të punës së gjyqtarit në drejtim të këtij treguesi, duke analizuar të gjitha llojet e çështjeve të përzgjedhura, pa i dhënë peshë dhe rëndësi të veçantë asnjërisë prej tyre.

Niveli i vlerësimit

<sup>30</sup> Mendim kundër bashkëlidhur vendimit nr. 22, datë 13.03.2019.

KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
78	Shumë mirë

## 2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

*Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjera.*

### 2.A Aftësia e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë.

#### 2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

*Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyrura në raportin analistik, rezulton gjyqtari {...} nuk ka gjykuar asnjë çështje jashtë afatit ligjor. Referuar të dhënavë statistikore të analizuara në raportin analistik, përqindja e çështjeve të përfunduara tej afatit ligjor të gjykimit është 0 %.*

Sa më sipër, duke iu referuar të dhënavë që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtari nuk ka gjykuar asnjë çështje jashtë afatit ligjor.

#### KONKLUZIONE:

Në tërësi, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar të dhënavë që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se raporti mes çështjeve të gjykuara tej afatit ligjor me totalin e çështjeve të përfunduara për të cilat ligji parashikon afate shqyrtimi, rezulton në masën 0 %, çka tregon se gjyqtari ka treguar kujdesin maksimal për përfundimin e gjykimit të çështjeve brenda afateve ligjore.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues, gjyqtari pikëzohet me 15 pikë, pasi përqindja e çështjeve të gjykuara jashtë afatit ligjor është 0%.*

#### 2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

*Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyrura në raportin analistik, rezulton se çështjet përgjithësisht kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor, me përjashtim të:*

- (i) 1 (një) çështje tek tabela nr. 2, tek kategoria e çështjeve "penale krimë", me nr. Rendor 6, akti nr. 5/79, datë regjistrimi 20.07.2018, nr. vendimi 56, datë vendimi 26.07.2017, e cila ka përfunduar jashtë afatit 9 (nëntë) mujor të parashikuar nga vendimi nr. 261/2 date 14.04.2010 ish KLD-së, i llogaritur ky afat nga data e shortit. Në këtë çështje standardi minimal kohor rezulton të jetë tejkaluar me 3 muaj e 6 ditë.

Gjyqtari dhe zëvendëskryetarja e gjykatës në Formularin e Integruar të Vlerësimit kanë parashtruar se aftësia e gjyqtarit në respektimin e standardeve minimale kohore është shumë e lartë.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, pikëzimi për këtë tregues përcaktohet duke iu referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të standardit minimal kohor me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji nuk parashikon afat ligjor gjykimi. Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të standardit minimal kohor (1 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara, pa përfshirë çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi (12 çështje), gjyqtari rezulton që të ketë gjykuar 8.3 % të çështjeve në tejkalim të standardit minimal kohor.

## KONKLUZIONE:

Në tërësi, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe analizës së mësipërme lidhur me afatin e gjykimit të çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, raporti i këtyre çështjeve me numrin total të çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, rezulton në masën 8.3 %, brenda marzhit "0-10%", që përkon me nivelin maksimal të pikëzimit.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:*** Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues, gjyqtari pikëzohet me 5 pikë, pasi përqindja e çështjeve të përfunduara në tejkalim të standardit minimal kohor rezulton të jetë 8.3 %, brenda marzhit "0-10 %" që përkon me nivelin maksimal të pikëzimit.

### **2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.**

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruar në reportin analistik,*** koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD-së, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, rezulton se :

- (i) për kategorinë "kërkesa të hetimit paraprak", koha mesatare rezulton të jetë 10.6 ditë, më e shkurtër se standardi minimal kohor 2/muaj i parashikuar nga vendimi nr. 261/2 datë 14.04.2010 ish-KLD-së;
- (ii) për kategorinë "penale krimë", koha mesatare rezulton të jetë 107.1 ditë, më e shkurtër se standardi minimal kohor 9/muaj i parashikuar nga vendimi nr. 261/2 datë 14.04.2010 ish-KLD-së;

(iii) për kategorinë “civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, koha mesatare rezulton të jetë 20 ditë, më e shkurtër se standardi minimal kohor 6/muaj i parashikuar nga vendimi nr. 261/2 datë 14.04.2010 ish KLD-së.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari dhe zëvendëskrytarja e gjykatës, lidhur me këtë tregues, evidentojnë faktin se gjyqtari i ka aftësi shumë të larta në respektimin e afateve kohore, sipas kategorisë.

Në tërësi, për të gjitha kategoritë e çështjeve (3 kategori), koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është dukshëm më e shkurtër se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve.

## KONKLUZIONE:

Në tërësi, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga analiza e burimeve të vlerësimit, si dhe krahasimit të kohës mesatare që i dedikohet çdo çështje për të gjitha kategoritë, me standardin minimal kohor në fuqi për kategori çështjesh, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e shkurtër se ky afat për të gjitha kategoritë.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje rezulton më e shkurtër se standardi minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve dhe gjyqtari pikëzohet me 5 pikë.*

### 2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

**Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruar në raportin analistik, rezulton se** rendimenti i përfundimit të çështjeve, si raport mes numrit të çështjeve të përfunduara, me numrin e çështjeve të caktuara brenda vitit kalendarik 2019, pra për periudhën e vlerësimit, është 103 %.

Në Formuarin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari dhe zëvendëskrytarja e gjykatës kanë parashtruar se gjyqtari ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në lidhje me rendimentin e përfundimit të çështjeve.

## KONKLUZIONE:

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësuar në tërësinë e tyre, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve është 103 %.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues, duke qenë se rendimenti i përfundimit të çështjeve është 103 %, shkalla e aftësisë së gjyqtarit është shumë e lartë dhe pikëzohet me 10 pikë.*

### 2.A.d Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.

**Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruar në reportin analistik, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh, krahasuar me afatin procedural të parashikuar në ligj, është si më poshtë:**

- (i) për kategorinë “penale krim”, koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor është 9.5 ditë, më e shkurtër se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 430/1, parag 4, i K.Pr.P;
- (ii) për kategorinë “kërkesa penale të hetimit paraprak”, për të cilat ligji procedural ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor është 3.85 ditë, më e shkurtër se afati procedural 10 ditë i parashikuar nga neni 249 i K.Pr.P;
- (iii) për kategorinë “kërkesa penale të hetimit paraprak”, për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor është 4.6 ditë, më e shkurtër se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 430/1, pg 4, i K.Pr.P;
- (iv) për kategorinë “civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor është 17 ditë, më e shkurtër se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308, pg 2, i K.Pr.C;

Në tërësi, për të gjitha kategoritë e çështjeve, koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor rezulton të jetë më e shkurtër se afati procedural.

## **KONKLUZIONE:**

Bazuar në të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për arsyetimin e vendimeve në një kohë të shpejtë dhe në çdo rast, brenda afatit procedural, për të gjitha kategoritë e çështjeve.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:*** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues pikëzohet me 15 pikë, duke qenë se koha mesatare e arsyetimit të vendimeve gjyqësore përfundimtare është më shkurtër se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve.

## **2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.**

***2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.***

Referuar tabelave me të dhëna statistikore dhe Raportit Analistik, rezulton se ka të dhëna të plota për numrin e seancave gjyqësore për të gjitha çështjet e përfunduara nga gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit. Sipas Metodologjisë së Pikëzimit, *për të pikëzuar këtë tregues vlerësuesi përcakton fillimisht numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh (civile, administrative, penale, dhe sipas shkallëve të gjykimit), duke përjashtuar ato pa palë kundërshtare*.

Sipas Raportit Analistik, sa i përket numrit të seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh me palë kundërshtare, rezulton si më poshtë:

- (i) për çështje të kategorisë “penale krim”, numri mesatar i seancave është 8;
- (ii) për çështje të kategorisë “civile të përgjithshme me palë kundërshtare<sup>31</sup>”, numri mesatar i seancave është 2;

Në total, për të gjitha çështjet me palë kundërshtare, numri mesatar i seancave gjyqësore është 7 (7.3) seanca.

Gjyqtari dhe zëvendëskryetarja e gjykatës, në Formularin e Integruar të Vlerësimit, lidhur me këtë tregues, e kanë vlerësuar aftësinë e gjyqtarit si “të lartë”, pa dhënë ndonjë arsyë apo shpjegim lidhur me numrin mesatar të seancave.

Sa i përket kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave jo-produktive, lidhur me çështjet me palë kundërshtare, të cilat konsiderohen për vlerësimin e këtij treguesi, sipas Metodologjisë së Pikëzimit<sup>32</sup>, rezulton se :

Në Gjykatat e Apelit të juridiksonit të përgjithshëm (*juridikson të cilit i përket çështja e vetme e kategorisë “civile të përgjithshme me palë kundërshtare” e përzgjedhur me short për vlerësim*<sup>33</sup>), ka një rregullim të posaçëm ligjor për përpunimin dhe vënien në lëvizje të çështjeve gjyqësore referuar nenit 460, pika 2 dhe 4 të Kodit të Procedurës Civile dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 78, datë 30.05.2019 “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit”, në të cilin përcaktohet “*Data e nxjerrjes për gjyq*” si veprim që përcakton kohën e fillimit të shqyrtimit të çështjes. Ky moment, përveç çështjeve për të cilat ligji procedural parashikon afat ligjor shqyrtimi, kushtëzohet nga kalendari i shqyrtimit të çështjeve, i cili duhet të marrë për bazë radhën, sipas kohës së ardhjes së dosjes në gjykatën e apelit për çështjet e ardhura mbi bazë apelimi dhe në rastet kur kjo gjykatë shqyrton çështje të juridiksonit fillestar, planifikimi i seancës së parë gjyqësore ndjek rregullat e përcaktuara në ligjet procedurale, duke mbajtur parasysh objektin e çështjes dhe kalendarin e shqyrtimit të çështjeve.

Sa i përket çështjeve penale, në referim të parashikimeve të nenit 426, pika 1 të K.Pr.P, vënia në lëvizje e çështjeve bëhet nga relatori, njëherësh edhe kryetari i kolegit të gjykatës së apelit, i cili *urdhëron thirrjen e të pandehurit, paditësit civil dhe të paditurit civil, si dhe të mbrojtësve e të përfaqësuesve të tyre dhe afati i paraqitjes nuk mund të jetë më i vogël se dhjetë ditë*.

Në dosjet e përzgjedhura me short për gjyqtarin {...}, rezulton se çështjet, pasi i janë caktuar me short në cilësinë e relatorit, janë vënë në lëvizje dhe planifikuar për t'u gjykuar brenda një afati të shkurtër kohor dhe në çdo rast duke respektuar afatet procedurale të përcaktuara në nenin 460 të K.Pr.C dhe nenin 426 të K.Pr.P, duke kryer me korrekësi veprimet paraprake të gjykimit sipas parashikimeve të nenit 426 të Kodit të Procedurës Penale dhe neneve 465 e vijues të Kodit të Procedurës Civile. Çështjet janë vënë në lëvizje kryesisht nga 1 deri në 9 ditë nga momenti i caktimit

<sup>31</sup>Për këtë kategori çështjesh gjyqtari {...} ka gjykuar vetëm një çështje ne cilësinë e relatorit, dhe konkretisht çështjen me nr. akti. 2166, datë regjistrimi 08.05.2018, nr. vendimi 232, datë vendimi 08.04.2019, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

<sup>32</sup> Në Metodologjinë e Pikëzimit, për këtë tregues, ndër të tjera parashikohet se : ”Për të pikëzuar këtë tregues vlerësuesi përcakton fillimisht numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh (civile, administrative, penale, dhe sipas shkallëve të gjykimit) duke përjashtuar ato pa palë ndërgjyqëse. Të gjitha të dhënata statistikore analizohen sipas situatës me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënavëve statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, si dhe në kujdesin që tregon gjyqtari për shmangien e seancave gjyqësore jo-produktive duke kryer me eficencë veprime të tillë si : - mbikëqyrja e dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit; - marrja e masave për të siguruar njoftime të rregullta për seancat pasardhëse; - planifikimi i seancave duke marrë parasysh kohëzgjatjen e çështjeve, afatet ligjore dhe mendimin e palëve; - si edhe çdo masë tjetër e marrë konkretisht nga gjyqtari për shmangien e seancave jo-produktive. ”.

<sup>33</sup> Çështja që i përket vendimit nr. 232, datë 08.04.2019 të Gjykatës së Apelit Vlorë.

të tyre me short, përveç një rasti kur çështja është vënë në lëvizje pas shqyrtimit të kërkesës së gjyqtarit për heqje dorë nga gjykimi<sup>34</sup>.

Pas vënies në lëvizje të çështjeve nëpërmjet caktimit të seancës së parë gjyqësore, rezulton se gjyqtari ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet në çdo rast janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve apo dështim i seancave gjyqësore për shkak të mungesës së tyre, dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruuar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë.

Në të gjitha çështjet e përzgjedhura me short të cilat përbëjnë burim vlerësimi për këtë tregues, shtyrja e seancave gjyqësore ka ndodhur për shkaqe objektive me natyrë procedurale, të tillë si:

- (i) Në çështjen që i përket vendimit nr. 32, datë 02.05.2019 të Gjykatës së Apelit për Krimet të Rënda, janë zhvilluar vetëm 2 seanca, nga të cilat një seancë është shtyrë për mosparaqitjen e mbrojtësit të të pandehurit. Për këtë shkak është proceduar me gjobitjen e avokatit dhe zëvendësimin e tij me mbrojtës kryesisht;
- (ii) Në çështjen që i përket vendimit nr.22, datë 13.03.2019, janë zhvilluar 2 seanca nga të cilat një seancë nuk është zhvilluar për shkak të mosformimit të trupit gjykues (*një nga anëtaret e trupit gjykues ka qenë i angazhuar në një aktivitet në Shkollën e Magjistraturës*);
- (iii) Në çështjen që i përket vendimit nr.12, datë 07.02.2019, janë zhvilluar 3 seanca gjyqësore nga të cilat dy janë shtyrë respektivisht për shkak të mosparaqitjes së mbrojtësit të të pandehurit dhe një për shpalljen e vendimit, duke u caktuar seanca pas 1/dite.
- (iv) Në çështjen që i përket vendimit nr.56, datë 26.07.2019, janë zhvilluar 37 seanca gjyqësore. Seancat janë shtyrë për shkaqe procedurale të tillë si : për shkak të mosparaqitjes së ekspertëve; njoftimit të ekspertit të ri të caktuar nga gjykata; dhënes e kohës së nevojshme për kryerjen e aktit të ekspertimit; dhënia e kohës përgjigjen e pyetjeve ndaj aktit të ekspertimit; mosparaqitja e mbrojtësit; dhënie e kohës palëve për përgatitjen e diskutimit përfundimtare; mosformimi i trupit gjykues; njoftimi i mbrojtësit të caktuar kryesisht; dhënia kohë mbrojtësit të caktuar kryesisht për t'u njojur me dosjen; pamundësi e vazhdimit të gjykimit për shkak të tejzgjatjes së seancës dhe angazhimeve në gjykime të tjera; shqyrtimi i kërkesës për përashtim si dhe për shpalljen e vendimit. Në rastet kur seancat janë shtyrë për mosparaqitjen të ekspertit dhe mbrojtësit, është proceduar me gjobitjen e tyre dhe zëvendësimin e mbrojtësit me mbrojtës të caktuar kryesisht;
- (v) Në çështjen civile që i përket vendimit nr. 232, datë 08.04.2019, të Gjykatës së Apelit Vlorë, janë zhvilluar 2 seanca nga të cilat seanca e parë është shtyrë për shkak të kërkesës së përligjur të përfaqësuesit të njërsë palë.

Në tërësi, konstatohet se shtyrjet e seancave kanë qenë për shkaqe objektive, të pavarura nga veprimet e gjykatës, por në funksion të shqyrtimit të çështjeve, konform një procesi të rregullt ligjor, në mënyrë që afati i arsyeshëm për shqyrtimin e çështjeve të mos bëhej shkak për cenimin e të drejtave procedurale të palëve në proces dhe në çdo rast seancat vijuese janë caktuar brenda një afati të shkurtër, pa kaluar afatin 15/ditor në çështjet penale dhe në një çështje civile, seanca e ardhshme është shtyrë pas 19/ditësh. Numri mesatar i seancave gjyqësore duket se është ndikuar ndjeshëm nga kohëzgjatja e një<sup>35</sup> çështje e cila është zhvilluar në 37 seanca dhe dy<sup>36</sup> çështjeve të tjera të cilat kanë përfunduar me 5 dhe 9 seanca, ndërkohë që pjesa tjetër e çështjeve (6 çështje) kanë përfunduar me 2 ose 3 seanca gjyqësore.

<sup>34</sup> Çështja që i përket vendimit nr. 22, datë 13.03.2019, të Gjykatës së Apelit për Krimet të Rënda.

<sup>35</sup>Çështja që i përket vendimit me nr. 56, datë 26.07.2019.

<sup>36</sup>Çështjet që i përkasin vendimeve nr. 26, datë 04.05.2019 dhe nr. 3, datë 24.12.2019.

Numri mesatar i seancave gjyqësore është më i lartë se 3/seanca në 3 nga 9 çështjet me palë kundërshtare të përfunduara nga gjyqtari, duke përbërë rrëth 33 % të tyre, por në çdo rast, nga vëzhgimi i dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, rezulton se shkak për shtyrjen e seancave kanë qenë kërkuesat e palëve, rrëthanat procedurale të gjykimit apo shkaqe objektive që lidhen me natyrën dhe kompleksitetin e çështjeve dhe në çdo rast gjyqtari ka marrë masa të përshtatshme dhe efektive për shmangien e seancave jo-produktive.

## KONKLUZIONE:

Referuar sa më sipër, për treguesin e “*numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive*”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga tabelat me të dhëna statistikore dhe vëzhgimi i 5 çështjeve me palë kundërshtare të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 7, pra më shumë se 3/seanca. Gjyqtari në çdo rast ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave jo-produktive, planifikimin dhe zhvillimin e në kohë dhe me efektivitet të tyre. Tejkalimi i numrit të seancave që përkon me pikëzimin maksimal me një mesatare prej 4 seancash, ka ardhur për shkak të kompeksitetit të disa çështjeve, ndërkohë që shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtari në shmangien e seancave joproduktive dhe administrimin e procesit në tërësi është e lartë, prandaj gjyqtari vlerësohet me 15 pikë.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:*** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “*numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive*” gjyqtari pikëzohet me 15 pikë, pasi pavarësisht se numri mesatar i seancave gjyqësore rezulton të jetë 7/seanca, në çdo rast gjyqtari ka treguar shkallë të lartë aftësie në shmangien e seancave joproduktive.

### **2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.**

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruar në raportin analistik, rezulton se,*** në çështjet civile të përzgjedhura me short, gjyqtari i ka vënë në lëvizje çështjet në kohë, duke respektuar parashikimet e neneve 460 pika 2 dhe 4 të Kodit të Procedurës Civile dhe Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 78 datë 30.05.2019 “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit” (për një çështje civile të përfunduar prej tij si i deleguar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë). Pas vënies në lëvizje të çështjes, gjyqtari në cilësinë e relatorit, në përputhje me kërkuesat dhe afatet ligjore ka caktuar seancën pas 18 ditësh nga caktimi i saj me short, duke urdhëruar njoftimin e palëve. Gjithashtu, rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara në procesverbalin audio të seancave si dhe në ekstraktin e mbajtur me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

Në çështjet penale të analizuara (5 çështje) gjyqtari ka vënë në lëvizje dosjen në një kohë të shkurtër, duke caktuar seancën e parë gjyqësore dhe urdhëruar njoftimin e palëve, seancë e cila, në përputhje me parashikimet e nenit 426 të Kodit të Procedurës Penale, është caktuar në distancë kohore prej 14 deri në 45 ditë në çështjet e themelit si dhe prej 5 ditësh në një çështje

me objekt ankim ndaj vendimit për vleftësim ndalimi dhe caktim mase sigurimi. Caktimi i seancës së parë gjyqësore pas 45 ditësh nga caktimi me short në një çështje<sup>37</sup>, ka ardhur si pasojë e paraqitjes dhe shqyrtimit të kërkesës së gjyqtarit për heqje dorë nga gjykimi si dhe shqyrtimit të kërkesës së tij drejtar KLGJ-së, pas mospranimit të kërkesës nga kryetari i gjykatës. Gjithsesi për caktimin e seancës se parë gjyqësore gjyqtari në cilësinë e relatorit, ka zbatuar nenin 426 pika 1 të K.Pr.Penale, duke e caktuar atë për një afat jo më pak se 10/ditë (pas 45 ditësh nga regjistrimi i çështjes në gjykatë) dhe çështja ka përfunduar brenda standardit minimal kohor.

Shtyrja e seancave gjyqësore, përveç rasteve kur në distancën nga njëra seancë në tjetrën është përfshirë muaji gusht gjatë së cilit zhvillohet leja vjetore e gjykatës, është caktuar brenda afateve të shkurtra kohore, duke respektuar afatin procedural 15/ditor të parashikuar nga neni 342/2 i Kodit të Procedurës Penale.

Në të gjitha dosjet e vëzhguara, drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligj për gjykimin në apel (*neni 464 i K.Pr.Civile dhe neni 426/a i K.Pr.Penale*) kur është gjykuar si shkallë e dytë mbi bazë ankimi, dhe referuar rregullave procedurale përkatëse për gjykimin në shkallë të parë, në rastet kur gjykata ka proceduar me përsëritjen e pjesshme të shqyrtimit gjyqësor<sup>38</sup>.

Gjatë zhvillimit të gjykimit, gjyqtari ka treguar kujdes për verifikimin e paraqitjes së palëve, mbrojtësve, përkthyesit, ekspertit, relativin e plotë të akteve të njoftimit të tyre, shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, procedimin me zëvendësimin e mbrojtësit dhe gjobitjen e mbrojtësit të zgjedhur kur shkaqet e mosparaqitjes së tij janë vlerësuar të pabazuara, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetur të gjykatës mbi këto kërkesat për prova të reja, përsëritjen e shqyrtimit gjyqësor, caktimin e ekspertit, betimin dhe caktimin e detyrave të tyre<sup>39</sup>, shtyrjen e seancave gjyqësore duke pasqyruar shkakun në çdo rast si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (*njoftimin e palëve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, gjobitjen e mbrojtësve, zëvendësimin e tyre me avokat kryesisht dhe njoftimin e tyre, etj.*).

Përgjithësisht seancat kanë filluar në kohë, me vonesa të vogla të cilat janë relatuar në shumicën e rasteve nga gjyqtari në fillim të seancës dhe rezultojnë të janë për shkaqe tërësisht objektive, të pavarura nga ana e gjykatës, pasi kanë ardhur si pasojë e vazhdimit tej parashikimit të seancave paraardhëse në të cilat anëtaret e trupit gjykues ose pjesëmarrësit në gjykim kanë qenë të angazhuar, pritjen për paraqitjen e palëve ose përfaqësuesve të tyre, etj.

Të gjitha seancat gjyqësore rezultojnë të janë dokumentuar nëpërmjet regjistrimit audio, si dhe pasqyrohen në mënyrë të përbledhur në ekstraktin e mbajtur me shkrim nga sekretarja gjyqësore, duke pasqyruar hapat kryesorë procedurale të gjykimit.

## KONKLUZIONE:

<sup>37</sup> Çështja që i përket vendimit nr. 22, datë 13.03.2019 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda.

<sup>38</sup> Çështja që i përket vendimit nr. 56, datë 26.07.2019 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda.

<sup>39</sup> Vendimi nr. 56, datë 26.07.2019 i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues, bazuar kjo në veprimet e kryera me korrektësi dhe efektivitet për planifikimin, mbikëqyrjen, zhvillimin dhe dokumentimin e veprimeve procedurale, duke respektuar në çdo rast standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit në apel.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:*** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 20 pikë.

## **2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore.**

### ***2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.***

**Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analistik,** lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes, rezulton se aktet në dosje janë renditur kryesisht duke ndjekur logjik (sipas llojit të akteve) dhe atë kronologjik brenda së njëjtës kategori (sipas datës së aktit). Pavarësisht se nuk ka një rregullim që të përcaktojë në mënyrë të shprehur mënyrën e renditjes së akteve ne dosjen gjyqësore, renditja duhet të jetë e tillë që të lehtësojë shfrytëzimin e saj. Në rastin konkret renditja e dosjeve fillon përgjithësisht me aktin e shortit, kërkesat e gjyqtarëve për heqje dorë nga gjykimi si dhe vendimet për disponimin mbi to, urdhër thirrje dhe njoftime, kërkesat e mbrojtësve për shtyrjen e seancave, parashtresa të palëve, shkresa drejtar institacioneve, konkluzionet përfundimtare të palëve, procesverbalet e seancave gjyqësore sipas datave, vendimi përfundimtar dhe mendimi i pakicës në rastet kur ka një të tillë. Rendi logjik dhe kronologjik brenda së njëjtës kategori aktesh, i jep dosjeve të shqyrtuara rregullsi dhe lehtësi në akses.

### **KONKLUZIONE:**

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin logjik duke u grupuar aktet sipas kategorisë dhe atë kronologjik brenda së njëjtës kategori, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore të rregullt dhe lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:*** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 5 pikë.

### ***2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.***

**Nga analiza e burimeve të vlerësimit , të pasqyruara në raportin analistik, rezulton se** në dosjet e përzgjedhura me short, ndodhen të gjitha aktet e gjykatës(aktet e shortit, kërkesat për

*heqje dorë nga gjykimi, vendimet për disponimin mbi to, korrespondenca me KLGJ-në lidhur me plotësimin e trupit gjykues, njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seance gjyqësore, vendimet gjyqësore, mendimi i pakicës në rastet kur gjykata ka vlerësuar ndryshe nga shumica) si dhe aktet e paraqitura nga palët (kërkesat e palëve, mbrojtësve, parashkrimet me shkrim, diskutimet përfundimtare të palëve).*

## KONKLUZIONE:

Duke qenë se nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete, vlerësoj se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është shumë e lartë dhe pikëzohet maksimalisht.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:*** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, është “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

## 3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

*Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.*

### 3.A Etika në punë

#### 3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

***Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruar në raportin analistik, rezulton se :***

*Sa i përket rezultateve të verifikimit të ankesave, referuar informacionit të përcjellë prej Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me shkresën nr. 1795/1prot., datë 24.08.2020 dhe shkresën nr. 2437/5prot., datë 09.11.2020 rezulton se për periudhën 01.01.2019 - 31.12.2019, për gjyqtarin {...}, janë depozituar tre ankesa të cilat janë verifikuar nga ILD duke konkluduar për arkivimin e tyre pas shqyrtimit fillestar, me vendimet nr. 763/3 prot, datë 06.11.2020 “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të dy ankesave të paraqitura nga z. Vilson Çobani” dhe*

vendimin nr. 1718/3 prot., datë 06.11.2020 “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës të paraqitur nga znj. Leonora Puto”.

Nga tërësia e fakteve të parashtruara dhe të analizuara në vendimet e ILD-së, nuk rezultojnë të dhëna për cenim të etikës apo elementë të tjera që ndikojnë në vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit.

Ndërkohë, sa i takon masave disiplinore, rezulton se për periudhën 01.01.2019 - 31.12.2019 për gjyqtarin {...} nuk është dhënë apo zbatuar asnje masë disiplinore.

Gjyqtari dhe zëvendëskrytarja e gjykatës në Formularin e Integruar të Vlerësimit i kanë vlerësuar shumë të larta aftësitë e gjyqtarit në drejtim të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Edhe pse nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyrhuara në raportin analistik, nuk evidentohet të ketë të dhëna të referuara në këtë tregues, nga analiza e burimeve të vlerësimit në kuadër të aftësive organizative të gjyqtarit në këtë raport, rezulton se një nga çështjet e përzgjedhura për vlerësim është vënë në lëvizje nga gjyqtari/relator pas 25/ditëve nga regjistrimi i saj në gjykatë. Kjo çështje është regjistruar në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda në dt. 18.01.2019 dhe sipas fletës së shortit rezulton t'i ketë kaluar për shqyrtim gjyqtarit relator në dt. 21.01.2019. Çështja ka përfunduar me vendimin Nr. 22 dt. 13.03.2019, ndërkohë që seanca e parë gjyqësore është caktuar me urdhrit e dt. 13.02.2019. Pavarësisht se kohëzgjatja e shqyrtimit është më e shkurtër se standardi minimal orientues, nga të dhënat e akteve të dosjes penale, evidentohen veprime dhe mosveprime që duhet të analizohen në drejtim të etikës në punë dhe përgjegjshmërisë në funksion të treguar nga gjyqtari.

Konkretisht :

Pas caktimit të çështjes për shqyrtim gjyqtarit relator {...} dhe anëtarëve të trupit gjykues A.B dhe S.D, nga ana e gjyqtarit relator në dt. 22.01.2019 është paraqitur para kryetarit te gjykatës kërkesa “për heqje dorë nga gjykimi”. Kjo kërkesë është refuzuar nga Kryetari i Gjykatës me vendimin Nr. 4 dt. 22.01.2019. Në dt. 24.01.2019 Kryetari i Gjykatës ka përcjellë para KLGJ-së kërkesën e gjyqtarit {...} me lëndë “*Njoftim mbi refuzimin e zbatimit të urdhrit të caktimit të çështjes së Kryetarit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë*”. Duke qenë se në dosjen gjyqësore ndodhej vetëm shkresa Nr. 395/2 Prot dt. 12.02.2019 e KLGJ drejtuar kryetarit të gjykatës dhe z. {...}, në kuadër të procedurës së vlerësimit u administrua e gjithë praktika dokumentare e shkresave të referuara si më sipër në dosjen gjyqësore, nga përbajtja e të cilave rezultoi se :

1. Me vendimin Nr. 72 dt. 24.09.2018 Gjykata e Apelit për Krime të Rënda me trup gjykues : kryesues Dh. {...} dhe anëtarë gjyqtarët A.B dhe S.D ka vendosur : “*Konstatimin e moskompetencës lëndore të Gjykatës për Krime të Rënda Tirane. Prishjen e vendimit n.83 dt. 17.07.2018 të kësaj gjykate dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë*”. Ndaj këtij vendimi ka ushtruar rekurs Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, duke kërkuar prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë.
2. Dosja penale i është përcjellë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila pas marrjes së çështjes për shqyrtim, me vendimin e dt. 25.10.2018 ka ngritur para Gjykatës së Lartë, çështje të mosmarrëveshjes së kompetencës lëndore midis dy gjykatave,

Gjykatës së Apelit për Krimë të Rënda dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë e për pasojë i ka dërguar aktet për të zgjidhur konfliktin e kompetencës Gjykatës së Lartë.

3. Me vendimin Nr.00-2018-432 dt. 27.12.2018 Gjykata e Lartë ka vendosur : “*Dërgimin e akteve Gjykatës së Apelit për Krimë të Rënda Tiranë për vazhdimin e gjykimit, si gjykatë që ka kompetencën lëndore për gjykimin e çështjes.....*” Në këtë vendim arsyetohet : “...Në të tilla rrethana, bazuar në vendimin njësues Nr. 13 dt. 04.04.2018, Kolegji çmon se kompetenca lëndore i përket Gjykatës së Krimëve të Rënda dhe se shqyrimi i rekursit të prokurorit, për shkak të ngritjes së çështjes së kompetencës lëndore dhe njohjes së kompetencës së Gjykatës për Krimë të Rënda, në fazën në të cilën ka mbetur gjykimi, nuk është më aktuale dhe çështja duhet të vijohet të shqyrtohet nga Gjykata e Apelit për Krimë të Rënda..”.
4. Në vijim në zbatim të vendimit të Gjykatës së Lartë çështja është regjistruar në Gjykatën e Apelit për Krimë të Rënda në dt. 18.01.2019. Në dt. 21.01.2019 me urdhrin Nr. 48 Kryetari i Gjykatës, në zbatim të vendimit të mësipërm të Gjykatës së Lartë dhe neneve 25, 37, 92/1 shkronja “a” të Ligjit 98/2016 si dhe vendimit të ish/KLD-së ende në fuqi Nr. 283/1/a dt. 24.12.2018...etj, ka vlerësuar se vazhdimi i shqyrimit të çështjes duhej të bëhej nga i njëjti trup gjykues, relator z. {...} dhe anëtarë A.B dhe S.D dhe e ka kaluar çështjen për gjykim pranë këtij trupi pa short.
5. Në dt. 22.01.2019 gjyqtari/kryesues z. {...} ka paraqitur dorëheqjen tek Kryetari, bazuar në nenin 15 të K.Pr.Penale, për shkak të papajtueshmërisë në procedim.
6. Në dt. 22.01.2019 me vendimin Nr. 4 Kryetari ka refuzuar dorëheqjen duke vlerësuar se rasti në fjalë nuk kishte të bënte me rigjykimin e çështjes dhe se Gjykata e Lartë kishte qenë ajo që kishte urdhëruar vazhdimin e gjykimit të kësaj çështje nga Gjykata e Apelit dhe jo rigjykimin e çështjes.
7. Pasi është njohur me vendimin e refuzimit të dorëheqjes gjyqtari ka ardhur në dijeni të faktit se caktimi i trupës gjyqësore që do të vazhdonte gjykimin në këtë rast ishte bërë pa short, por me urdhër të kryetarit, të cilin ka refuzuar ta zbatojë dhe nuk ka kryer asnjë veprim për vënин në lëvizje të çështjes. Në të njëjtën kohë gjyqtari i është drejtuar KLGJ duke kërkuar ndërhyrjen e Këshillit për hedhjen në short të çështjes e moszvarritjen e mëtejshme të saj. Kërkesa e gjyqtarit Dh.{...} është përcjellë në KLGJ nga kryetari i gjykatës në dt. 24.01.2019.
8. Po në dt. 24.01.2019 kryetari i gjykatës i është drejtuar KLGJ duke e njoftuar se gjyqtari Dh.{...} e kishte kthyer dosjen pa veprime në sekretari dhe se ai refuzonte të zbatonte urdhrin e tij për caktimin e çështjes për gjykim.
9. Çështja është vënë në lëvizje nga gjyqtari {...} pas ndërhyrjes së KLGJ-së dhe ka përfunduar me vendimin Nr. 22 dt. 13.03.2019.

Në analizë të rrethanave të mësipërme, vlerësoj se refuzimi i zbatimit nga ana e gjyqtarit të urdhrit të caktimit të çështjes, i shoqëruar me moskryerjen e asnjë veprimi paraprak nga ato që kérkon neni 426 i K.Pr.Penale dhe me rikthimin e dosjes pa veprime në kryesekretari, është shfaqje e një sjellje të pakujdeshme dhe tregues i mungesës së vetëpërbajtjes së gjyqtarit, çka afekton në shkallën e angazhimit dhe përgjegjshmërisë së tij në funksion. Pavarësisht dakordësisë ose jo me urdhrin e kryetarit për caktimin e çështjes për gjykim dhe njoftimit të organeve përgjegjëse për parregullsitë e konstatuara, gjyqtari me veprime apo mosveprime, në thelb nuk mund të refuzojë të gjykojë një çështje të caktuar.

Ndryshe nga sa parashtron gjyqtari në kundërshtimet e tij, evidentimi i sjelljeve të mësipërme nuk është bërë jashtë burimeve të vlerësimit për këtë tregues. Aktet e dosjeve të përzgjedhura

me short, përbëjnë një nga burimet e vlerësimit të parashikuara në nenin 77 të Ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në R. Shqipërisë” i ndryshuar. Ndarja e burimeve në Metodologjinë e Pikëzimit, më vete për çdo tregues, është bërë për lehtësi referimi tek ato burime ku të dhënat janë të mundshme të gjenden. Por lista e burimeve që përmban Metodologjia për çdo tregues nuk është shteruese, por orjentuese. Dosja gjyqësore ku është evidentuar sjellja e mësipërme e gjyqtarit, ka qenë një nga dosjet e përzgjedhura me anë të shortit në gjykatë.

## KONKLUZIONE:

Në tërsi, referuar tërsisë së të dhënavët mësipërme që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në zbatim të parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit, shkalla e etikës në punë të treguar nga gjyqtari vlerësohet “mbi mesatare” duke u pikëzuar me 28 pikë.

*Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënavët që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e etikës së gjyqtarit në treguesin “angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” është “mbi mesatare” duke u pikëzuar me 28 pikë.*

## 3.B Integriteti i gjyqtarit

### *3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti.*

*Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruar në raportin analistik, për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, rezulton se:*

Gjatë periudhës së vlerësimit viti 2019, rezulton të jenë regjistruar pranë ILD-së tre ankesa ndaj gjyqtarit {...}, me të dhënat si vijon:

(i) Me vendimin nr. 763/3 prot, datë 06.11.2020, ILD ka trajtuar ankesën me nr. 763 prot, datë 01.06.2020 (depozituar fillimisht në KLGJ me nr. 334 prot, datë 22.01.2019) të shtetasit Vilson Çobani. Ankuesi parashtron se gjatë një gjykimi të zhvilluar në Gjykatën e Apelit Gjirokastër, trupa gjyqësore, në përbërje të së cilës ka qene edhe gjyqtari {...}, me vendimin e datës 28.01.2019 ka vendosur “Miratimin e vendimit nr. 23-2018-1012, datë 07.06.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë për mosfillimin e procedimit penal”. Shkaqet e ankesave të ankuesit<sup>40</sup> lidhen me pretendime se ndaj tij është zhvilluar një proces gjyqësor i padrejtë nga gjyqtarët e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Nure Dreni, {...} dhe Saida Dollani. ILD pasi ka shqyrtuar shkaqet e ankimit ka vlerësuar se *pretendimet e ankuesit janë të tillë që kanë të bëjnë me zgjidhjen në themel të çështjes gjyqësore lidhur me vendimin e Gjykatës së Apelit Gjirokastër, vendimi i cili i nënshtronhet kontrollit gjyqësor nga një gjykatë më e lartë, rrugë e cila është ndjekur nga ankuesi me paraqitjen e rekursit ndaj vendimit të datës 28.01.2019*. Mbi këtë arsyetim, ILD ka vlerësuar se pretendimet e ankuesit nuk janë të natyrës që përbëjnë shkelje disiplinore dhe po ashtu, në ankesat e tij mungojnë

<sup>40</sup> *Sipas vendimit te ILD rezulton se janë bashkuar dhe trajtuar së bashku dy ankesa për shkak se ishin paraqitur nga i njëjtë ankues dhe ndaj të njëjtëve magjistratë.*

dyshimet e arsyeshme të cilat justifikojnë fillimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratëve, për ndonjë shkelje disiplinore konkrete.

(ii) Me vendimin nr. 1718/3 prot, datë 06.11.2020, ILD ka trajtuar ankesën me nr. 6359 prot, datë 23.12.2019 të shtetas Leonora Puto. Ankuesja parashtron se me vendimin nr. 167, datë 15.08.2019 të trupës gjyqësore të përbërë nga gjyqtarët Nure Dreni, {...} dhe Nertina Kosova, me të cilin është rrëzuar ankimi i saj ndaj vendimit për Gjykatës së shkallës së Parë për Krime të Rënda, ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal, gjyqtarët kanë shkelur ligjin. ILD pasi ka trajtuar ankesat, ka vlerësuar se *trajtimi i pretendimeve për zbatim të gabuar të rregullave procedurale dhe materiale gjatë gjykimit, bazuar në parashikimet e K.Pr.P, është kompetencë e gjykatave më të larta në rast ushtrimi të njeteve procedurale të ankimit* dhe nuk është kompetencë e ILD, referuar parashikimeve të nenit 147/d të Kushtetutës dhe nenit 194 të Ligjit nr.115/2016.

Nga tërësia e fakteve të parashtruara dhe të analizuara në vendimet e ILD-së, nuk rezulton asnjë e dhënë që të dëshmojë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtarit, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmëritë e publikut.

Në raportin e ILDKPKI, përcjellë pranë KLGP me shkresën nr. 194/24prot., datë 29.06.2020, konkludohet se : a) *Deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin; b) Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë; c) Nuk ka kryer fshehje të pasurisë; d) Nuk ka kryer deklarim të rremë; e) Kandidati nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit, gjyqtari dhe zëvendëskrytarja e gjykatës e kanë vlerësuar në shkallë shumë të lartë integritetin e gjyqtarit. Zëvendëskrytarja e gjykatës lidhur me këtë tregues parashtron se : ”*Bazuar në etikën, integritetin dhe paanësinë e gjyqtarit, mbi prezumimin se gjyqtari i ka këto cilësi, nuk është konstatuar asnjë problematikë e shfaqur nga gjyqtari, duke e vlerësuar shumë të lartë”*”.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicje që të dëshmojë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cunim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarit, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim apo çdo sjelle tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtarit.

## KONKLUZIONE:

Në tërësi, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimit të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të cenojnë integritetin e gjyqtarit, gjyqtari {...} pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

***Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi:*** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e integritetit të gjyqtarit në treguesin “shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.

## 3.C Paanësia e gjyqtarit

### **3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.**

**Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruar në raportin analistik**, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtari në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, në përbajtje të akteve shkresore të administruara në dosjet gjyqësore apo në përbajtje të vendimeve përfundimtare/mendimeve të pakicës të hartuara prej tij. Gjithashtu nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve të administruara në dosjet e gjykimit si dhe të dhënavë nga vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe vlerësimi i zëvendëskrytares së gjykatës.

### **KONKLUZIONE:**

Në tërësi, referuar të dhënavë që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose përbajtjen e akteve të hartuara prej tij. Për këto arsy, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

**Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënavë që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit në treguesin “shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

### **3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtarit.**

**Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruar në raportin analistik**, rezulton se për periudhën 01 janar 2019 – 31 dhjetor 2019, janë paraqitur 2 (dy) kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit të cilat janë rrëzuar. Gjithashtu rezulton të jenë paraqitur prej tij 12 (dymbëdhjetë) kërkesa për heqje dorë nga gjykimi nga të cilat 10 (dhjetë) janë pranuar.

Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar, rezulton se:

Gjyqtari {...} ka paraqitur gjatë vitit 2019, dymbëdhjetë kërkesë për heqje dorë nga gjykimi, të cilat janë trajtuar me vendim nga kryetari i gjykatës. Sipas vendimeve bashkëlidhur, rezulton se 10 prej tyre janë pranuar me vendimet respektive të kryetarit të gjykatës, pasi kanë pasur në thelb shkak të përligjur duke qenë se gjyqtari ka qenë në kushtet e papajtueshmërisë për të marrë pjesë në gjykim, sepse kishte shqyrtuar më parë kërkesa të fazës së hetimit paraprak lidhur me çështjet<sup>41</sup> ose është vlerësuar se çështja i është caktuar me short në mënyrë të gabuar, pa respektuar listën e gatishmërisë për shqyrtimin e çështjeve urgjente<sup>42</sup>.

<sup>41</sup>Vendimet nr. 13, datë 12.04.2019, nr.17, datë 17.04.2019, nr.27, datë 21.05.2019, nr. 39, datë 11.06.2019, nr.45, datë 01.07.2019, nr. 53, datë 16.07.2019, nr. 58, datë 06.09.2019, nr. 71, datë 11.11.2019, nr. 87, 18.12.2019.

<sup>42</sup> Vendimi nr. 40, datë 14.06.2019.

Në dy kërkesat për heqje dorë të cilat janë refuzuar, rezulton se shkaqet e paraqitjes së kërkesës në një rast lidhen me paraqitjen nga ana e palës ndërgjyqëse të një kallëzimi penal për një çështje të mëparshme të gjykuar nga gjyqtari<sup>43</sup> dhe në një rast për shkak të vlerësimit të gjyqtarit se, pas vendimit të Gjykatës së Lartë që ka zgjidhur konfliktin e kompetencës lëndore midis gjykatave, pasi ai ka vlerësuar se ka marrë pjesë në një shkalle të procedimit si dhe për të shmangur konsideratat për vendimin e Gjykatës së Lartë që ka dërguar çështjen për vazhdimin e gjykimit në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda<sup>44</sup>.

Nga tërësia e shkaqeve të parashtruara për heqjen dorë nga gjykimi, trajtuar me vendimet respektive të kryetarit të gjykatës, nuk rezultojnë elementë që mund të ndikojnë në vlerësimin e këtij treguesi apo në tregues të tjera të kritereve të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit.

Gjyqtari dhe zëvendëskrytarja e gjykatës, në Formularin e Integruar të Vlerësimit, lidhur me këtë tregues, e kanë vlerësuar këtë tregues në nivelin “i pakonsiderueshëm”, duke mos dhënë komente.

## KONKLUZIONE:

Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, referuar të dhënavë burimore për mos ekzistencën e asnjë kërkese të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues pikëzohet maksimalisht.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënavë që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “numri tejet i lartë i kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtarit” gjyqtari pikëzohet me 15 pikë, pasi numri i kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e tij është 0 (zero), për pasojë vlerësohet si “i pakonsiderueshëm”.

Nivelin i vlerësimit KRITERI ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Pikët	Nivel i vlerësimit
93	Shkëlqyeshëm

## 4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

<sup>43</sup> Vendimi nr. 20, datë 19.04.2019.

<sup>44</sup> Vendimi nr. 4, datë 22.01.2019.

*Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit ne drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.*

#### **4.A Aftësia e komunikimit.**

##### **4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.**

*Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruar në raportin analistik rezulton se gjyqtari gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është i qartë, transparent, i drejtpërdrejtë dhe i kuptueshëm. Gjithashtu, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe për pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare, ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë.*

Të njëjtat cilësi evidentohen edhe në vetëvlerësimin e gjyqtarit dhe vlerësimin e zëvendëskryetares së gjykatës, lidhur me këtë tregues.

#### **KONKLUZIONE:**

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari në çdo rast komunikon në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes për të qenë i qartë, i drejtpërdrejtë dhe i kuptueshëm.

*Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “komunikimi i qartë dhe transparent” është “shumë e lartë” dhe duhet të pikëzohet me 25 pikë.*

##### **4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.**

*Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruar në raportin analistik, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.*

#### **KONKLUZIONE:**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

**Respektimi i konfidencialitetit nga gjiqtari dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit për treguesin “respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

#### **4.B Aftësia për të bashkëpunuar**

**4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njojurive dhe përvojës profesionale me ta.**

**Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruar në raportin analistik,** nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie përmes mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit.

Gjyqtari dhe zëvendëskrytarja e gjykatës e kanë vlerësuar maksimalisht këtë tregues duke mos dhënë komente.

#### **KONKLUZIONE:**

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët si dhe shkëmbimi i njojurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë dhe nuk rezultojnë të dhëna që mund të ndikojnë në vlerësim për këtë tregues.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, e shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njojurive dhe përvojës profesionale me ta” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 15 pikë.

#### **4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore.**

**Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruar në raportin analistik** nuk rezultojnë të dhëna negative përmes shkallës e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore ndërkokë që gjyqtari dhe zëvendëskrytarja e gjykatës e kanë vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë duke mos dhënë komente.

#### **KONKLUZIONE:**

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, është shumë e lartë dhe nuk rezultojnë të dhëna që mund të ndikojnë në vlerësim për këtë tregues.

**Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** *Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.*

#### **4.C Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera.**

##### **4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.**

**Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruesha në raportin analistik** rezulton se gjyqtari {...} për vitin 2019, është ftuar për të marrë pjesë në cilësinë e pjesëmarrësit në dy aktivitete trajnuese, pjesë e Programit të Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës<sup>45</sup>, si më poshtë:

- (i) Aktiviteti trajnues i datës 22 shkurt 2019, me temë :"Zbatimi dhe efektshmëria e vendimeve të GJEDNJ në gjykimin penal të brendshëm (kombëtar), ligji procedural dhe praktika në vështrim të shkronjës "d" të nenit 450 të K.Pr.P".
- (ii) Aktiviteti trajnues i datave 27 dhe 28 shkurt 2019, me temë :"Veprimet paragjykimore të GJEDNJ. Baza ligjore dhe rëndësia e vendimeve paragjykimore. Dialogu i gjyqtarëve kombëtare me GJEDNJ. Kompetenca ekskluzive e GJEDNJ.....".
- (iii) Aktiviteti trajnues i datës 29 mars 2019, me temë :"Ne bis in idem, si prezumim juridik. Raporti me vendimin penal të ekzekutueshëm, sipas të drejtës penale dhe asaj ndërkomëtare.".

Sipas shkresës së Shkollës së Magjistraturës me nr. 535/1 prot., datë 05.08.2020 gjyqtari nuk ka marrë pjesë në këto tri aktivitete trajnuese në të cilat ka qenë i ftuar në cilësinë e pjesëmarrësit.

Po ashtu, rezulton se gjyqtari {...} është miratuar për të marrë pjesë në cilësinë e ekspertit në dy aktivitetet trajnuese si më poshtë:

- (i) Aktiviteti trajnues i datave 3 dhe 4 prill 2019, me temë :"Procesverbali i seancës gjyqësore në procesin penal. Transkriptimi. Pavlefshmëria e akteve. Analizë e dispozitave procedurale penale me fokus nenet 115-117,122-130 të K.Pr.P.".
- (ii) Aktiviteti trajnues i datave 29 dhe 30 maj 2019, me temë :"Ankimi kundër vendimit të mosfillimit të procedimit penal dhe kundër vendimit të pushimit të çështjes ose akuzës, në rastin e kundërvajtjeve penale. Roli i gjyqtarit të hetimeve paraprake dhe i seancës paraprake dhe problemet e praktikës gjyqësore.".

Sipas shkresës së Shkollës së Magjistraturës me nr. 535/1 prot., datë 05.08.2020 gjyqtari nuk ka konfirmuar pjesëmarrjen në këto aktivitete dhe nuk ka qenë i pranishëm për arsyet objektive.

<sup>45</sup>Shkresa me nr. 535/1 prot, datë 05.08.2020 e Shkollës së Magjistraturës.

Në Formularin e Integruar të Vetëvlerësimit, lidhur me këtë tregues, gjyqtari ka parashtruar se ka plotësuar detyrimin për pjesëmarrjen në programin e formimit vazhdues dhe në trajnime të tjera profesionale gjatë periudhës së vlerësimit, por nuk ka parashtruar asnjë të dhënë për aktivitetet trajnuese në të cilat ai mund të ketë marrë pjesë.

Sipas parashikimeve të nenit 5 pika 3 të Ligjit për Statusin *periudha e formimit vazhdues duhet të jetë: a) jo më pak se pesë ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë pesë viteve; b) jo më shumë se 40 ditë në vit dhe 200 ditë gjatë pesë viteve.*

Ndërkojë në pikën 1 dhe 2 të nenit 5 të Ligjit për Statusin parashikohet se :”*1. Magjistrati ka të drejtë dhe detyrimin të marrë pjesë në programet e formimit vazhdues. Magjistrati ka të drejtë të propozojë tema trajnimi dhe të bashkëpunojë me Këshillin, me qëllim përmirësimin e programeve të trajnimit. 2. Magjistrati duhet: a) të ndjekë formimin vazhdues, në përputhje me legjislacionin në fuqi;*”.

Në rastin konkret, në momentin e hartimit të projektraportit të vlerësimit, për gjyqtarin {...}, nuk rezultonin të dhëna për përbushjen e detyrimit ligjor për pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese gjatë periudhës së vlerësimit janar-dhjetor 2019.

Pasi është njojur me projektraportin e vlerësimit bashke me kundërshtimet e tij gjyqtari ka paraqitur një provë të re, nga e cila rezulton pjesëmarrja e tij vetëm në një trajnim 2/ditor, në datat 13-14 nëntor 2019, trajnim i realizuar jashtë programit të SHM.

Referuar Metodologjisë gjatë periudhës së vlerësimit 3 vjeçare, gjyqtari pikëzohet me 20 pikë, nëse përbush detyrimin e pjesëmarrjes në trajnime jo më pak se 15/ditë dhe jo më shumë se 120 ditë, në 3/vjet. Nëse gjyqtari rezulton pjesëmarrës në më pak se 15/ditë ose më shumë se 120/ditë, gjatë periudhës 3/vjeçare të vlerësimit, ai pikëzohet me 4/pikë. Në rastin konkret gjyqtari nuk ka përbushur detyrimin ligjor për pjesëmarrje të detyrueshme në trajnime, për jo më pak se 5 ditë të plota në vit (rezulton vetëm 2/ditë angazhim), të parashikuar nga neni 5 pika 3 shkronja “a” e Ligjit 96/2016. Pavarësisht ekzistencës së shkaqeve që mund të kenë ndikuar në mospërbushjen e detyrimit ligjor për të marrë pjesë në programet e trajnimit vazhdues, të cilat analizohen në kuadër të shkeljes disiplinore (neni 102 i Ligjit 96/2016 i ndryshuar), për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit, vlerësohet vetëm pjesëmarrja dhe kohëzgjatja e saj. Në kushtet kur për gjyqtarin rezultojnë vetëm 2 (dy) ditë pjesëmarrje në programin e trajnimit vazhdues, ai pikëzohet me 4 (katër) pikë.

Lidhur me kontributin e pretenduar nëpërmjet botimit të librit “Koment mbi Kodin e Procedurës Penale”, gjyqtari do të vlerësohet në treguesin e “publikimeve ligjore”, pasi ky kontribut nuk përbën pjesëmarrje në aktivitet trajnues.

## KONKLUZIONE:

Në rastin konkret gjyqtari rezulton të ketë marrë pjesë vetëm në 2/ditë aktivitet trajnues gjatë periudhës së vlerësimit, duke mospërbushur të paktën kufirin minimal të pjesëmarrjes vjetore në aktivitete trajnuese, të përcaktuar nga Ligji për Statusin, prej 5/ditësh në vit.

**Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, duke qenë se pjesëmarrja e gjyqtarit në aktivitetet trajnuese të Sh. M dhe trajnime të tjera është 2 (dy) ditë në vit (për periudhën e vlerësimit viti 2019) ai pikëzohet për këtë tregues me 4 pikë.

#### **4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.**

**Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruar në raportin analistik** rezulton se gjyqtari {...}, përgjatë vitit kalendarik 2019, ka qenë i miratuar për të marrë pjesë në cilësinë e ekspertit në dy aktivitete trajnuese si më poshtë:

- (i) Aktiviteti trajnues i datave 3 dhe 4 prill 2019, me temë :"Procesverbali i seancës gjyqësore në procesin penal. Transkriptimi. Pavlefshmëria e akteve. Analizë e dispozitave procedurale penale me fokus nenet 115-117,122-130 të K.Pr.P.".
- (ii) Aktiviteti trajnues i datave 29 dhe 30 maj 2019, me temë :"Ankimi kundër vendimit të mosfillimit të procedimit penal dhe kundër vendimit të pushimit të çështjes ose akuzës, në rastin e kundërvajtjeve penale. Roli i gjyqtarit të hetimeve paraprake dhe i seancës paraprake dhe problemet e praktikës gjyqësore.".

Sipas shkresës së Shkollës së Magjistraturës me nr. 535/1 prot., datë 05.08.2020 gjyqtari nuk ka konfirmuar pjesëmarrjen në këto aktivitete dhe nuk ka qene i pranishëm për arsyet objektive.

Lidhur me disponueshmërinë e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional, nuk rezultojnë të dhëna.

Në Formularin e Integruar të Vetëvlerësimit, lidhur me këtë tregues, gjyqtari ka parashtruar: "Gjithnjë i gatshëm – autor i librit "Koment mbi Procedurën Penale", botuar nga Shkolla e Magjistraturës, si vepër e përputhur me programin e formimit fillestar dhe vazhdues".

#### **KONKLUZIONE:**

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tillë jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për ketë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'i u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtarin {...}, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e tij në cilësinë e ekspertit në aktivitete trajnuese në Shkollën e Magjistraturës apo aktivitete të tjera trajnuese, ky tregues pikëzohet me 3 pikë.

**Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” gjyqtari pikëzohet me 3 pikë.

**4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.**

*Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analistik, nuk rezultojnë të dhëna për këtë tregues.*

Gjyqtari në Formularin e Integruar të Vlerësimit, lidhur me këtë tregues, ka parashtruar se: "Deri në vitin 2016 funksioni gjyqësor i gjyqtarit ishte i papërputhur me këdo funksion apo veprimtari tjeter. Aktualisht, ky funksion vazhdon të jetë i tillë me përjashtim të atij të mësimdhënies së kontrolluar. Pikërisht për këtë të fundit kam kontribuar me shkrimin e librit profesional "Koment mbi Procedurën Penale", botuar nga Shkolla e Magjistraturës, që e bën të spikatur dhe shumë kualitativ kontributin tim në aktivitete mësimdhënës për çështje ligjore.". Zëvendëskryetarja e gjykatës, sa i përket këtij treguesi, ka parashtruar se :"Sipas shpjegimit të gjyqtarit pasqyrohet gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera."

Lidhur me kontributin e pretenduar nëpërmjet botimit të librit “Koment mbi Kodin e Procedurës Penale”, gjyqtari do të vlerësohet në treguesin e “publikimeve ligjore”, pasi ky kontribut nuk përbën angazhim në veprimtari ndërinstolucionale. Ndërsa lidhur me kontributin e pretenduar si veprimtari ndërinsucionale, për shkak të pjesëmarrjes në veprimtarinë e organizuar nga KLGJ në dt. 04.11.2019 për të diskutuar lidhur me aktet plotësuese të Skemës së Vlerësimit të Gjyqtarëve, vlerësohet se vetëm pjesëmarrja nuk është e mjaftueshme. Ajo tregon gadishmërinë e gjyqtarit për të kontribuar, çka është marrë parasysh në Metodologjinë e Pikëzimit, sipas të cilës të gjithë gjyqtarët e fillojnë vlerësimin sipas këtij treguesi me 3 pikë. Pavarësisht se angazhimi i gjyqtarëve në punët e Këshillit është mbi baza vullnetare dhe pa pagesë, vlerësohet vetëm kontributi konkret i tyre në hartimin e akteve nënligjore me qëllimin primar përmirësimin e punës në gjykatë, kontribut i cili në rastin konkret mungon.

## **KONKLUZIONE:**

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimitari të tillë jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për ketë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iua shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimitari, për gjyqtarin {...}, ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë, pasi nuk rezultojnë të dhëna.

**Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se për treguesin “angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata” gjyqtari duhet të pikëzohet me 3 pikë.

#### **4.C.ç Publikimet ligjore akademike.**

**Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruar në raportin analistik,** në lidhje me angazhimin e gjyqtarit në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, rezulton se gjyqtari {...} është autor i botimit “Koment mbi Procedurën Penale”, publikuar në vitin 2019, botuar nga shtëpia botuese “Morava”, me ISBN 9789928208781, me numër faqesh 1727, botuar nën kujdesin e Shkollës së Magjistraturës.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit, për gjyqtarin {...}, ky tregues duhet të pikëzohet maksimalisht.

#### **KONKLUSIONE**

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtari ka realizuar një publikim ligjor me vlerë akademike, studimore dhe shkencore në periudhën e vlerësimit dhe për pasojë, vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.

#### **Angazhimi i gjyqtarit dhe pikëzimi.**

Referuar sa më sipër, për treguesin “publikime ligjore akademike” rezulton angazhimi i gjyqtarit dhe për këtë shkak ai pikëzohet me 5 pikë.

#### **Niveli i vlerësimit**

#### **KRITERI**

#### **AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL**

Pikët	Niveli i vlerësimit
80	Shumë mirë

#### **NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT**

#### **Propozim për nivelin e vlerësimit për çdo kriter**

Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitetë profesionale të gjyqtarit	78	Shumë mirë

2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	93	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	80	Shumë mirë
<b>Niveli i përgjithshëm i vlerësimit</b>		
Vlerësimi i përgjithshëm	351	Shumë mirë

## PROPOZIME DHE REKOMANDIME

Bazuar në nenin 93 pika 5 shkronja “ç” të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënavë të analizuara dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekandohet që gjyqtari {...} të mbajë në konsideratë angazhimin e tij të vazhdueshëm dhe përmbrashjen e detyrimit ligjor për pjesëmarrjen në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve si dhe në veprimtari ndërinstitucionale, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhëni e kontributit për përmirësimin e sistemit gjyqësor.

## SHTOJCA 1

### KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTARIN {...} PERIUDHA E VLERËSIMIT 1 JANAR 2019- 31 DHJETOR 2019

#### 1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Treguesit		Burimet	Shkalla e aftësisë
<b>A. Njohuritë ligjore</b>	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Mbi mesataren

	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Mesatare
<b>B. Arsyetimi ligjor</b>	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Mbi mesataren
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarit 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Mbi mesataren

## 2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Tregues	Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	
<b>A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë</b>	a. Respektimi i afateve ligjore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10 %

	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10%
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Mbi +99 %
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve

<b>B. Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedural gjyqësore</b>	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	1. Të dhënrat statistikore/aktet e dosjeve të përzgjedhura me short  2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit  3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short  2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit  3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë
<b>C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore</b>	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short  2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short  2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë

### 3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Tregues	Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit
<b>A. Etika në punë</b>	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1. Informacioni i marrë nga ILD  2. Dosja personale e

		<p>gjyqtarit</p> <p>3. Vetëvlerësimi i gjyqtarit</p> <p>4. Mendimi përfundimtar i kryetarit</p>	
<b>B. Integriteti i gjyqtarit</b>	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	<p>1. Informacioni i marrë nga ILD</p> <p>2. Dosja personale e gjyqtarit</p> <p>3. Mendimi përfundimtar i kryetarit</p> <p>4. Të dhënat e raportit të ILDKPKI</p>	Shumë e lartë
<b>C. Paanësia e gjyqtarit</b>	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	<p>1. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim</p> <p>2. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim</p>	Shumë e lartë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuara të palëve për përashtimin e gjyqtarit	<p>1. Të dhënat statistikore</p> <p>2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit</p> <p>3. Mendimi përfundimtar i kryetarit</p>	I pa konsiderueshëm

#### 4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Tregues	Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit
<b>A. Aftësia e komunikimit</b>	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	<p>1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit</p> <p>2. Mendimi përfundimtar i kryetarit</p> <p>3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim</p> <p>4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short</p>

	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	I lartë
<b>B. Aftësia për të bashkëpunuar</b>	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë
<b>C. Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera</b>	a. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Dokumente të dorëzuara nga gjyqtari	0 ditë (periudha 1/vjeçare)
	b. Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucionë të tjera	Nuk të dhëna
	c. Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Dosja personale e gjyqtarit 4. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të gjyqtarit	Nuk ka të dhëna
	ç. Publikimet ligjore akademike	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen	Ka të dhëna

		profesionale të tij	
<b>PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT</b>			
<b>NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT</b>			<b>Shumë e lartë</b>